

VENDIM
Nr. 1140, datë 24.12.2020

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE
KRIMEVE TË RËNDA, 2021–2025, DHE PLANIN E VEPRIMIT 2023–2025**

*(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 10.11.2021; nr. 54, datë 1.2.2023; nr. 458,
datë 10.7.2024)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025, dhe planin e veprimit 2023–2025, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, ministritë dhe institucionet përgjegjëse të përmendura në tekstin e kësaj Strategjie për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

STRATEGJIA FINALE

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtimeve

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

1.1 Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik

1.2 Vizioni i Strategjisë

1.3 Metodologjia

1.4 Analiza e riskut, arritjet dhe mësimet

1.5 Kuadri ligjor dhe institucional në fuqi, lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike

PJESA II: QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË DOKUMENTIT STRATEGJIK

2.1 Qëllimi i politikës I: Ulja e kërcënimit dhe e ndikimit të krimit të organizuar dhe të krimeve të rënda.

Objektivi specifik 1.1 Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve

Objektivi specifik 1.2 Goditja e trafikeve të paligjshme

Objektivi specifik 1.3 Goditja e krimit ekonomik të pastrimit të parave

Objektivi specifik 1.4 Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i drejtuesve dhe i anëtarëve të strukturave kriminale

Objektivi specifik 1.5 Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar

Objektivi specifik 1.6 Kapja e personave në kërkim ndërkombëtar

Objektivi specifik 1.7 Forcimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja

2.2 Qëllimi i politikës II: Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë

Objektivi specifik 2.1 Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar

Objektivi specifik 2.2 Rritja e profesionalizmit

Objektivi specifik 2.3 Dobësimi i motivit financiar në përfshirje në krim të organizuar

2.3 Qëllimi i politikës III: Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda

Objektivi specifik 3.1 Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar

Objektivi specifik 3.2 Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël

PJESA III: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

3.1 Përgjegjësia e institucioneve

3.2 Llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi

PJESA IV: ANALIZA BUXHETORE

4.1 Analiza e buxhetit për zbatimin e Strategjisë

LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
AISM	Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
AKCESK	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
AMF	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
AS	Akademia e Sigurisë
BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
BSH	Banka e Shqipërisë
DASH	Departamenti Amerikan i Shtetit
DHKA	Dhoma Kombëtare e Avokatisë
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DVP	Drejtoritë Vendore të Policisë
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
EMCDDA	Qendra Evropiane e Monitorimit të Narkotikëve dhe Varësisë nga Droga
EMPACT	Platforma multidisiplinare evropiane kundër kërcënimeve kriminale
FAST	Njësia për Kapjen e Personave në Kërkim
FATF	Task-Forca e Veprimit Financiar
FZHR	Fondi për Zhvillimin e Rajoneve
GKO	Grupet e krimit të organizuar
IKRTK	Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes

MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NSPK/SPZ	Ndihmëspecialist i policimit në komunitet
PP	Prokuroria e Përgjithshme
PSH	Policia e Shtetit
PU	Policia Ushtarake
QEDH	Qendra për Ekstremizmin e Dhunshëm
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SIENA	Aplikacioni i sigurt i rrjetit të shkëmbimit të informacionit
SKKOKR	Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit

PJESA I KONTEKSTI STRATEGJIK

1.1 Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik

Strategjia Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda është hartuar në vijim të dy strategjive të mëparshme: Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqueve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2008–2013, dhe Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqueve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013–2020. Ndryshe nga dokumentet e mëparshme, kjo Strategji përqendrohet në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke u fokusuar në komponentët kryesorë të saj, si: trafikimi i drogave, njerëzve, armëve, veprave të artit dhe trashëgimisë kulturore, pastrimi i parave dhe strukturat e organizuara kriminale.

Zhvillimi i Strategjisë i është nënshtruar një procesi konsultativ ndërmjet institucioneve shtetërore të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, të cilat do të japin kontributin kryesor në zbatimin e kësaj Strategjie dhe monitorimin e ecurisë së saj.

Strategjia bazohet mbi të dhëna dhe vlerësime të institucioneve dhe të agjencive të zbatimit të ligjit dhe të inteligjencës, si dhe raporte të jashtme vlerësimi të institucioneve ndërkombëtare dhe vendore.

Procesi i hartimit të Strategjisë ka kaluar nëpër disa faza:

Faza e parë ka konsistuar në vlerësimin e kërcënimit nga krimi i organizuar, duke u mbështetur në matjen e rezultateve të arritura gjatë zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafiqueve të Paligjshme, 2013–2020. Nëpërmjet këtij vlerësimi janë identifikuar mangësitë dhe nevojat në qasjen e deritanishme kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, mbi të cilat janë zhvilluar gjatë fazës së dytë qëllimet e politikave/politikat, objektivat specifike të Strategjisë, si dhe treguesit e performancës për të matur arritjet. Pjesë përbërëse e këtij vlerësimi kanë qenë dhe gjetjet dhe rekomandimet e ofruara nga raportet e pavarura ndërkombëtare dhe ato vendore, të cilat kanë trajtuar vit pas viti çështje që lidhen me zbatimin e ligjit dhe luftën kundër krimit të organizuar në Shqipëri. Gjithashtu, një sërë dokumentesh Strategjike dhe praktikash të mira ndërkombëtare në këtë fushë janë konsultuar dhe kanë shërbyer për fazën tre dhe katër të këtij procesi. Gjatë fazës së tretë është kryer hartimi i dokumentit përfundimtar dhe hartimi i Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për periudhën 2021–2022, ndërsa gjatë fazës së katërt është kryer procesi i konsultimit me publikun dhe palët e interesuara.

Kapitujt në vijim të këtij dokumenti Strategjik do të trajtojnë një sërë çështjesh që lidhen me hapat që janë ndjekur për të arritur këtë Strategji, synimet dhe pritshmëritë e saj, si dhe zbatimin dhe monitorimin e objektivave të përcaktuar.

Në pjesën e parë të këtij dokumenti do të pasqyrohet një vlerësim i përgjithshëm i përpjekjeve, arritjeve dhe sfidave në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda në vend, duke u mbështetur në analizat e brendshme të institucioneve shqiptare, si dhe duke u referuar në raportet kryesore të institucioneve dhe organizmave ndërkombëtarë që mbulojnë këto çështje. Në këtë pjesë do të përcaktohet vizioni i Strategjisë, i cili do të jetë qëllimi kryesor i përpjekjeve të përbashkëta të institucioneve shqiptare në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, si dhe do të evidentohet lidhja e kësaj Strategjie me kuadrin ligjor në fuqi dhe dokumentet e tjera strategjike në këtë fushë.

Pjesa e dytë fokusohet në qasjen strategjike që do të ndiqet në këtë dokument, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar tri politikat kryesore të kësaj Strategjie, si dhe objektivat specifike për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në përballjen kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda.

Pjesa e tretë përcakton masat prioritare që do të zbatohen nga institucionet për secilën prej tre politikave dhe së fundmi, pjesa e katërt pasqyron planin e veprimit 2021–2022, nëpërmjet të cilit do të synohet vënia në jetë e politikave dhe e objektivave specifike, ndarja e përgjegjësisë ndërmjet institucioneve, si përcaktimi i afateve për zbatimin e masave.

1.2 Vizioni i Strategjisë

Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të koordinojë përpjekjet e institucioneve shqiptare ndaj një sërë problematikash dhe sfidash në fushën e sigurisë, të cilat janë evidentuar në vija të përgjithshme në analizën e riskut dhe do të kenë si busull orientuese vizionin e kësaj Strategjie:

“Garantimi i një mjedisi të sigurt për zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë nga kërcënimet e krimit të organizuar dhe e krimeve të rënda, duke siguruar jetën e individit, sipërmarrjen e lirë dhe respektimin e ligjshmërisë në tërësi.”

Ky vizion është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020, ku lufta kundër krimit të organizuar lidhet me shtyllën e “Mirëqeverisjes, demokracisë dhe shtetit të së drejtës” dhe mbështet vizionin e SKZHI-së: *“Shqipëria me një shoqëri pa trafikim, krim të organizuar dhe kërcënime terrorizmi, dhe një imazh të një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë”*, në lidhje me objektivat e parashikuara për krijimin e një mjedisi të sigurt për shoqërinë përmes uljes së ofertës dhe të mundësive për përdorim të paligjshëm të narkotikëve, uljen e trafikimit të paligjshëm dhe, në veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmes Shqipërisë deri më 2020–ën, si dhe krijimin e një shërbimi hetimor bashkëkohor, forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal.

Sfidat që parashikon të ndeshë kjo Strategji lidhen, gjithashtu, me sfidat e parashtruara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015–2020: 1. Përpjekje më të mëdha në forcimin e bashkëpunimit midis agjencive të zbatimit të ligjit; 2. Krijimin e “të dhënave të gjurmueshme”, të besueshme të hetimeve parandaluese, të proceseve dhe dënimeve të shoqëruara me përdorimin sistematik të hetimeve financiare; 3. Përsheptimin dhe intensifikimin e luftës kundër prodhimit dhe trafikimit të drogave për të pasur një efekt më afatgjatë; dhe për 4. Një luftë më të bashkërenduar dhe të fokusuar ndaj të gjitha formave të krimit të organizuar dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe kundërmasa më të forta.

1.3 Metodologjia

Siç është shpjeguar më poshtë në nënkapitullin 5 - kuadri ligjor dhe institucional në fuqi dhe lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike të këtij dokumenti, përputhet plotësisht me dokumentet strategjike në nivel ndërkombëtar e kombëtar të miratuar nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, duke bërë që vizioni, politikat dhe objektivat specifike të përputhen plotësisht me këto dokumente strategjike.

Hartimi i kësaj Strategjie është planifikuar në kuadër të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2020–2022, duke i dhënë një rol koordinues Ministrisë së Brendshme, si institucioni me peshën

më të madhe në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Ky dokument strategjik është konsultuar në të gjitha fazat e saj, duke nisur nga analiza e riskut deri në miratimin e tij, me institucione të tjera si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Prokuroria e Përgjithshme etj., të cilat kanë dhënë kontribut të veçantë gjatë procesit të hartimit të kësaj Strategjie.

Në hartimin e këtij dokumenti krahas infrastrukturës ligjore, programeve të ndryshme shtetërore, në analizën për vlerësimin e gjendjes dhe planifikimin e prioriteteve, objektivave dhe alternativave të zhvillimit për të ardhmen, janë marrë në konsideratë edhe gjetjet dhe rekomandimet e bëra nga raportet ndërkombëtare, si rekomandimet e progresraporteve të Komisionit Evropian, Komitetit të Stabilizim-Asociimit, GRETA-s, DASH-it, ICRG/FATF-it etj.

Gjithashtu, ky dokument është publikuar për Konsultim publik në fillim të dhjetorit 2020, në adresën: <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/313>, dhe nuk ka pasur komente apo sugjerime të tjera në lidhje me përmbajtjen.

1.4. Analiza e riskut, arritjet dhe mësimet

Krahas vlerësimeve periodike të kryera nga institucionet shqiptare, organizma ndërkombëtarë, të pavarur dhe të paanshëm, raportojnë, se: “Shqipëria ka bërë përparim të mirë në forcimin e luftës kundër krimit të organizuar ... dhe rezultate të prekshme janë arritur në këtë drejtim”¹. Sipas Komisionit Evropian, përparimi i bërë në këtë drejtim nga vendi ynë dëshmohet përmes intensifikimit të mëtejshëm të operacioneve policore për shkatërrimin e grupeve kriminale ... dhe angazhimit të fortë për të shkatërruar trafikimin e drogës.²

Ndër faktorët kyç që kanë çuar në një numër të konsiderueshëm të operacioneve të suksesshme dhe në arrestimin e drejtuesve të grupeve të organizuara kriminale, përmenden bashkëpunimi me vendet anëtare të BE-së dhe Europolin, rritja e bashkëpunimit midis policisë dhe prokurorisë, zbatimi i *acuqis* të BE-së në këtë fushë, përbushja e rekomandimeve të vazhdueshme, si dhe zbatimi i planit të veprimit për adresimin e kërkesave të FATF-së. Një vëmendje e posaçme i është kushtuar, gjithashtu, rëndësisë dhe rolit të institucioneve të reja të drejtësisë, konkretisht Prokuroria e Posaçme. Vijimi i zbatimit të reformës në drejtësi dhe punës për luftën kundër krimit të organizuar, vlerësohen të një rëndësie jetike nga Departamenti Amerikan i Shtetit.³

Për sa u përket rezultateve në luftën kundër narkotikëve, raportohet, se: “ashtu si vitet e kaluara, Shqipëria dëshmoi, gjithashtu, më 2019-ën, një përkushtim të fortë dhe të qëndrueshëm në luftën kundër prodhimit dhe trafikimit të kanabisit”. Faktorë kyç në këtë drejtim përmenden lejimi i monitorimit ajror nga *Guardia di Finanza* italiane, bashkëfinancuar nga BE-ja, puna e ekipeve të përbashkëta të hetimit dhe operacionet në shkallë të gjerë në lidhje me kokainën dhe heroinën, në bashkëpunim me autoritetet policore të vendeve fqinje, veçanërisht me Italinë, të cilat kanë ndihmuar në identifikimin dhe ndjekjen penale të organizatave kriminale gjatë operacioneve të trafikimit të narkotikëve, përfshirë ato të kryera nga deti. Si rezultat i këtyre operacioneve, janë rritur, gjithashtu, sekuestrimet e sasive të hashashit. Komisioni Evropian, në raportin e tij të vitit 2020, mbi vendin tonë vlerësoi, gjithashtu, vazhdimin e bashkëpunimit me Qendrën Evropiane të Monitorimit të Narkotikëve dhe Varësisë nga Droga (EMCDDA), mbështetur dhe në marrëveshjen e punës të nënshkruar në muajin mars 2019, mes Shqipërisë dhe EMCDDA-së. Faktorë të natyrës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, përfshirë dhe përpjekjet e vendit për integrimin në Bashkimin Evropian janë vlerësuar me ndikim pozitiv në drejtim të rritjes së volumit të drogave të sekuestruara dhe numrit të arrestimeve lidhur me këto çështje gjatë vitit 2019, edhe

¹ EU Commission, Albania 2020 Report, Brussels, 6.10.2020 pg 6 https://ec.europa.eu/neighbourhoosites/near/files/albania_report_2020.pdf

² Po aty.

³ United States Department of State, International Narcotics Control Strategy Report, Albania 2020, pg 93, <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/06/Tab-1-INCSR-Vol.-I-Final-for-Printing-1-29-20-508-4.pdf>

nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Ky i fundit, sjell në vëmendje se ndonëse roli i Shqipërisë si vend burimi dhe tregtimi i drogave kryesisht të forta mbetet i ulët, ka një rritje të sasive të sekuestruara të kokainës në Evropën Perëndimore me përfshirjen e grupeve kriminale shqiptare.

Krahas vazhdimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke përfshirë adresimin e tendencave të reja në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike, nevojitet që autoritetet shqiptare të marrin masa shtesë të karakterit politik, legjislativ dhe organizativ. Ndër nevojat e identifikuar, përfshihen miratimi i Strategjisë dhe i planit kombëtar për drogat, rishikimi i legjislacionit mbi barnat narkotike dhe substancat psikotrope, përditësimi i listës së substancave të ndaluara psikoaktive dhe ngritja e Observatorit Kombëtar të Drogave dhe e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm për substancat e reja psikoaktive.

Referuar sfidave, rezultateve të arritura dhe rekomandimeve për forcimin e luftës kundër trafikeve të paligjshme, vendi ynë vijon të raportohet si një vend burimi, tranziti dhe destinacioni për trafikimin e qenieve njerëzore. Viktimat përfshijnë gra dhe fëmijë, të cilët i nënshtrohen trafikimit për shfrytëzim seksual dhe të punës, në vendet fqinje dhe shtetet anëtare të BE-së.

Shqipëria ka forcuar përpjekjet për parandalimin dhe për mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe ka vijuar masat për zbatimin e ligjit.⁴ Në dhjetor 2019, Shqipëria miratoi masa shtesë për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore, veçanërisht duke rritur kontrollimin e detajuar nga ana e Policisë së Shtetit për të miturit që largohen nga vendi. Mekanizmi kombëtar i referimit për viktimat (e mundshme) të trafikimit vlerësohet plotësisht funksional. Megjithatë, autoritetet shqiptare duhet të rrisin përpjekjet për identifikimin e hershëm të viktimave dhe viktimave të mundshme, intensifikimin e bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, si dhe në riintegrimin e suksesshëm të viktimave. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet fëmijëve të pashoqëruar dhe fëmijëve viktimë të trafikimit, duke u siguruar atyre, gjithashtu, mbrojtjen e duhur.

Referuar veprimtarisë së paligjshme të trafikimit të armëve, vendi ynë konsiderohet një vend tranzit dhe destinacion për armët e lehta. Shqipëria ka miratuar “Strategjinë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve, 2019–2024, dhe Planin e Veprimit 2019–2021, si dhe ka marrë pjesë në mënyrë aktive në ciklin e politikave të BE-së – Planin e veprimit operativ EMPACT mbi armët e zjarrit.

Trafikimi i paligjshëm i pasurive kulturore është një çështje tjetër që sjell pasoja të shumta në shoqërinë tonë, duke shkaktuar dëm historik, pasi pengon studimet shkencore dhe kuptimin e së kaluarës, dëm kulturor, që çon në humbjen e identitetit të vendeve të origjinës, si dhe dëm shoqëror, duke qenë shpesh një burim i financimit të veprimtarisë kriminale dhe duke dëmtuar ekonominë e vendeve të origjinës.

Trafikimi i paligjshëm i pasurive kulturore si format e tjera të trafikimit të paligjshëm është një çështje komplekse, e gjerë dhe gjithëpërfshirëse. Mund të marrë forma të ndryshme, të përfshijë vende të shumta dhe të shërbejë për qëllime të ndryshme, varësisht nga konteksti gjeografik, socioekonomik dhe politik. Është një aktivitet kriminal shumë i madh dhe fitimprurës, përfshin rrjete dhe tregje ilegale transnacionale, gjeneron një humbje të trashëgimisë, financon krime të tjera.

Lufta kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore kërkon legjislacion të fortë, ndërgjegjësim, si dhe bashkëpunim ndërsektorial. Në Strategjinë Ndërsektoriale të saj “Për luftën kundër krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm dhe terrorizmit, 2013–2020”, Qeveria e Shqipërisë ka treguar, gjithashtu, përparësi dhe angazhim për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore të luajtshme.

Institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese shqiptare kanë kryer një sërë operacionesh, me qëllim zbulimin, identifikimin, gjetjen e objekteve dhe hetimin e dënimin e autorëve të përfshirë në këto

⁴ United States Department of State, Trafficking in Persons Report, Albania 2020, <https://www.state.gov/reports/2020-trafficking-in-persons-report/albania/>

forma të trafikimit. Për shkak të rëndësisë madhore që ka ruajtja e veprave të trashëgimisë kulturore, objektiva dhe masa të detajuar janë parashikuar për zbatim nga institucione dhe agjenci të ndryshme ligjzbatuese në një plan veprimi të posaçëm, i cili plotëson dhe shoqëron këtë Strategji.

Sipas vlerësimit të Task-Forcës së Veprimit Financiar (FATF), Shqipëria ka ndërmarrë hapa në drejtim të forcimit të efektivitetit të regjimit të saj kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke përfshirë miratimin e legjislacionit për zbatimin e regjistrimit për pronarët përfitues, marrjen e masave për reduktimin e ekonomisë informale dhe përdorimin e *cash*-it dhe ngritjen e ekipeve të specializuara dhe zyrtarëve për hetimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave, në çdo qark.⁵ Megjithatë Komisioni Evropian ka vlerësuar një lloj progresi lidhur me sekuestrimet dhe konfiskimet e pasurive kriminale, numri i çështjeve me dënime përfundimtare për pastrim parash mbetet i ulët. Krahas vijimit të zbatimit të Planit të Veprimit të dakordësuar me Task-Forcën e Veprimit Financiar për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nevojiten përpjekje për të forcuar hetimet financiare dhe luftën kundër pastrimit të parave. Një vëmendje e shtuar i duhet kushtuar identifikimit dhe konfiskimit të pasurive kriminale të vendosura jashtë vendit ose të paarrtshme, zbatimit të rregullave për konfiskimin e zgjeruar dhe ngrirjen paraprake të pasurive, si dhe përdorimit sistematik të hetimeve paralele financiare për krimin e organizuar, të cilat duhet të shoqërojnë sistematikisht procedimet penale që nga fillimi.

Çdo vit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit kryen një vlerësim kombëtar të kërcënimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke përfshirë vlerësimin e riskut të grupeve kriminale, në mënyrë që të ketë një panoramë të krimit dhe kërcënimeve me të cilat përballet dhe të vendosë për masat operationale për adresimin e tyre. Institucione dhe agjenci të tjera ligjzbatuese mbledhin, hartojnë dhe shkëmbejnë të dhëna dhe informacione rreth veprimtarisë së paligjshme të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, mbështetur në fushën e veprimit dhe përgjegjësitë e tyre ligjore.

Bashkëpunimi policor me shtetet anëtare të BE-së dhe Europolit është intensifikuar, duke çuar në një numër të konsiderueshëm të operationeve të suksesshme dhe arrestimin e drejtuesve të grupeve të strukturuar kriminale. Agjencitë shqiptare të zbatimit të ligjit përdorin marrëveshjen operationale me Europolin, përmes shkëmbimit proaktiv dhe në kohë të informacionit përmes SIENA, si dhe përdorin ekipe të përbashkëta hetimore për të kryer hetime me homologët e BE-së.

Shqipëria merr pjesë, gjithashtu, në projektet e analizave operationale të Europolit, si dhe në projekte analizash lidhur me krimin kibernetik, krimin mjedisor, krimin e organizuar për pasuritë, terrorizmin, kontrabandën e migrantëve, trafikimin e qenieve njerëzore, armët dhe eksplozivët. Zyra Ndërlidhëse e Europolit në Shqipëri, e hapur zyrtarisht në muajin korrik 2019, ishte e para që operoi në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Vendi ynë ka shkëmbyer gjithnjë e më shumë informacion me Europolin dhe u bashkua me Rrjetin Operacional Informal kundër Pastrimit të Parave në vitin 2019, si dhe u bë një partner strategjik në luftën kundër “krimit të organizuar të pronës”, një nga fushat me përparësi të hetimit të krimit të Europol dhe një prioritet për sa i takon Platformës Evropiane Multidisiplinare kundër Kërcënimeve Kriminale (EMPACT).

Komisioni Evropian ka vlerësuar në vitin 2020, se numri dhe cilësia e mesazheve të shkëmbyera përmes aplikacionit të sigurt të rrjetit të shkëmbimit të informacionit (SIENA) është përmirësuar ndjeshëm që nga fundi i vitit 2019 dhe se ka pasur zhvillime pozitive në bashkëpunimin me Interpolin. Hapja në muajin korrik 2019 dhe funksionimi i Zyrës Ndërlidhëse të Europolit në Shqipëri, e cila ishte e para zyrë që operoi në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe roli i Oficerit Ndërlidhës në Tiranë ndihmuan në forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit policor me Europolin dhe vendet anëtare. Për më tepër, Shqipëria ka vijuar të bashkëpunojë mirë në çështjet penale, duke përfshirë këtu vendet anëtare të BE-së. Marrëveshja e saj e bashkëpunimit me *Eurojust*, e cila hyri në fuqi në 1 nëntor 2019, pritet të lehtësojë më tej bashkëpunimin gjyqësor ndërmjet autoriteteve

⁵ Financial Action Task Force (FATF), Albania <http://www.fatf-gafi.org/countries/di/iceland/documents/increased-monitoring-october-2020.html>

shqiptare dhe atyre të BE-së në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar. Megjithatë, duhet të përmirësohet më tej bashkëpunimi juridiksional ndërkombëtar, zbatimi në kohë i instrumenteve shumëpalëshe dhe kapaciteti institucional. Këto përpjekje duhet të shoqërohen nga përpjekjet e mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin me *acquis* të BE-së dhe për të nxitur shkëmbimin e praktikave më të mira në bashkëpunimin gjyqësor.

Në nëntor të vitit 2017, qeveria shqiptare mori vendim për krijimin e operacionit “Forca e ligjit”. “Forca e ligjit” u konceptua si një strukturë e veçantë brenda Policisë së Shtetit me oficerë të dedikuar për luftën ndaj krimit të organizuar. Një nga detyrat e para të “Forcës së ligjit” ishte krijimi i një harte të saktë mbi grupet e krimit të organizuar, fushën e tyre të veprimtarisë, ndikimin në territor, identifikimin e udhëheqësve, anëtarëve, financuesve, aseteve dhe aktiviteteve financiare të pastrimit të produkteve të krimit. Pas kësaj pune paraprake, në gati tri vite, operacioni “Forca e ligjit” ka arritur një sërë rezultatesh konkrete nëpërmjet operacioneve policore të kryera, të cilat kanë çuar në arrestimin e një numri të konsiderueshëm të anëtarëve të grupeve kriminale dhe sekuestrimin e aseteve të tyre me vlerë rreth 120 milionë euro.

Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, në muajin korrik 2019 u krijua Njësia për Kapjen e Personave në Kërkim (*Fugitive Active Searching Team*) “Fast Albania”. Në shkurt të vitit 2020 kjo njësi u bë pjesë e rrjetit evropian ENFAST, duke u bërë kështu vendi i parë në Ballkanin Perëndimor, joanëtar i BE-së, që ka krijuar një njësi të tillë të specializuar. Njësia është e fokusuar në kapjen e personave të rrezikshëm në kërkim dhe në bashkëpunim me njësitë simotra të BE-së dhe deri në muajin shtator 2020, ka kontribuar në kapjen e 22 shumë të kërkuarve, të huaj apo shqiptarë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Sa i përket krijimit të institucioneve të reja, si rezultat i reformës së sistemit të drejtësisë u krijua një gjykatë e veçantë (GJKKO), një prokurori e veçantë (SPAK) dhe një njësi e hetimore e veçantë (BKH), sipas modelit amerikan të FBI-së. Të tria këto institucione kanë objektiv kryesor luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, kanë një legjislacion të veçantë për organizimin dhe funksionimin, janë totalisht të pavaruara nga organet e tjera të kontrollit të sistemit të drejtësisë dhe operojnë vetëm në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit të tyre të organizimit. Kjo formë e re organizimi dhe funksionimi ka eliminuar një problem serioz të hasur ndër vite, atë të varësisë funksionale dhe organizative nga hallkat qeverisëse të sistemit të drejtësisë. Të tria këto institucione përbëhen nga gjyqtarë, prokurorë dhe hetues që i janë nënshtruar paraprakisht një procesi rivlerësimi (*vetting*), sa i përket figurës, pasurisë dhe profesionalizmit.

Duke qenë se krijimi i institucioneve të veçanta, sidomos i njësisë speciale të hetimit (BKH) kërkonte kohë për t’u realizuar, qeveria shqiptare ndërmoi disa masa të menjëhershme për të asistuar institucionet e sistemit të drejtësisë në luftën ndaj krimit të organizuar dhe të korrupsionit.

Një rëndësi e veçantë iu kushtua legjislacionit në dispozicion të institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese. Në luftën ndaj krimit të organizuar institucionet dhe agjencitë përdorin jo vetëm legjislacionin penal, por edhe forma të tjera edhe më proaktive, siç është legjislacioni parandalues.

Shqipëria ka një traditë në adaptimin e legjislacionit parandalues që në vitin 2004, me miratimin e ligjit të parë të ashtuquajtur antimafia, sipas modelit italian. Pavarësisht ndryshimeve të shpeshta në vite, thelbi i këtij legjislacioni nuk kishte ndryshuar, ai ka qenë i përqendruar vetëm mbi ato që quhen masa pasurore, pra sekuestrimi dhe konfiskimi i të mirave dhe aseteve të personave të përfshirë në aktivitete kriminale.

Më 31 janar 2020, me iniciativë të qeverisë, ky legjislacion u kompletua nëpërmjet adaptimit të aktit normativ nr. 1, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”.

Legjislacioni i ri, akoma edhe më agresiv, parashikoi krahmasave pasurore ekzistuese të sekuestrimit dhe të konfiskimit, masa parandaluese personale, si: mbikëqyrja speciale e personave apo masa ekonomike si ndalimi i marrjes pjesë të ndërmarrjeve të caktuara private në tendera publikë apo koncesione.

Ky legjisllacion ofroi një instrument akoma edhe më efikas në duart e institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese shqiptare, sepse mundësoi një aksion të koordinuar dhe kompleks ndaj krimit të organizuar, përmes zbatimit të masave parandaluese personale, masave parandaluese pasurore, si sekuestrimi apo konfiskimi i aseteve, mundësojnë kufizimin e fuqisë financiare të individëve apo të grupeve kriminale, si dhe të masave ekonomike, si heqja e licencave apo lejeve apo ndalimi i marrjes pjesë në tendera publike të shoqërive tregtare, të cilat mundësojnë kufizimin e injektimit të parave kriminale në ekonomi.

1.5. Kuadri ligjor dhe institucional në fuqi, lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike

Shqipëria ka një kuadër të plotë ligjor dhe nënligjor, si dhe një bazë të konsiderueshme dokumentesh strategjike, që adresojnë çështjet e krimit të organizuar dhe të krimeve të rënda. Një nga prioritetet kryesore në Programin e Qeverisë Shqiptare dhe prioritetet e Ministrisë së Brendshme është forcimi i rendit dhe sigurisë publike, duke parashikuar këtu luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme, narkotikëve etj.

Kuadri ligjor për luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda është i gjerë dhe përfshin një tërësi ligjesh, aktesh nënligjore, që përbëjnë bazën e nevojshme rregullatore për këtë fushë, të tilla si:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- ligji nr. 108/2014, datë 31.7.2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar;
- ligji nr. 103/2014, datë 31.7.2014, “Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”;
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, ku përcaktohet kompetenca e hetimit të veprave penale, që lidhen me krimin e organizuar, si dhe ligji nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, në bazë të të cilit është krijuar Prokuroria e Posaçme, që ka në kompetencë hetimin e veprave të kryera nga krimi i organizuar;
- Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar. Ky ligj ka për qëllim të parandalojë pastrimin e parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale;
- Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për eliminimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimin, nëpërmjet masave ndaluese kundër pasurisë”, zbatohen edhe për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, edhe për pjesëmarrje në organizata kriminale ose në banda të armatosura;
- Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 44, datë 10.6.2009, “Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;
- Me ligjin nr. 9110, datë 24.7.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krimet e Rënda”, u krijua Gjykata Për Krime të Rënda dhe Prokuroria për Krimet e Rënda, e cila ka në kompetencë edhe hetimin e veprave penale, në fushën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda;
- ligji nr. 10173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”;
- ligji nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”;
- ligji nr. 79/2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”;
- akti normativ nr. 1, datë 31.1.2020, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”;
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020;

- Strategjia Ndërsektoriale e Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013–2020 dhe planit të veprimit 2013–2016;

- Për miratimin e planit të veprimit për vitet 2019–2020, për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013–2020;

- Plan Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018–2020;

- Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Planin e Veprimit 2019–2022;

- Prioritetet e Ministrit të Brendshëm;

- Marrëveshje me EUROPOL, INTERPOL;

- Task-Forca Antiskifter;

- Konventa kundër krimit të organizuar transnacional etj.

Ky dokument strategjik është e ndërlidhur dhe kontribuon në parimet që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, kapitulli Qeverisja e Mirë, Demokracia dhe Shtetit i së Drejtës e lidhur me këto objektiva strategjike:

Krijimi i një mjedisi të sigurt për shoqërinë përmes uljes së ofertës dhe mundësive për përdorim të paligjshëm të narkotikëve;

Ulja e trafikimit të paligjshëm dhe, në veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmes Shqipërisë deri në 2020;

Përmirësimi i eficiencës në luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar, pastrimit të parave, korrupsionit dhe të ardhurave nga krimi;

Rritja e efikasitetit të njësisë së krimeve kibernetike;

Krijimi i një shërbimi hetimor bashkëkohor;

Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal.

PJESA II

QËLLIMI I POLITIKAVE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË TË DOKUMENTIT STRATEGJIK

2.1 Qëllimi i politikës I: Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda

Lufta ndaj krimit të organizuar dhe krimeve të rënda përbën një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Brendshme, si dhe është një ndër kriteret kryesore për procesin e anëtarësimit të vendit në BE. Konsolidimi i shtetit të së drejtës dhe rritja e sigurisë në vend janë të lidhura ngushtësisht me rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike në institucionet ligjzbatuese, përmirësimin e kuadrit ligjor, përmirësimin e cilësisë hetimore dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërkombëtar.

Kjo Strategji dhe plani i veprimit që e shoqëron mbështetet në vizionin e qeverisë për mbrojtjen e qytetarëve dhe përparimit të vendit nga kërcënimet dhe ndikimi i krimit të organizuar dhe krimet e rënda, përmes zvogëlimit të risqeve dhe rritjes së fuqisë parandaluese.

Ky dokument do të jetë një udhërrëfyes për zbatimin në praktikë të qasjes gjithëpërfshirëse kundër veprimtarive të paligjshme dhe strukturave të krimit të organizuar, e cila përfshin ndërveprimin midis qeverisë, sektorit privat, komunitetit dhe qytetarëve.

Prioritetet, objektivat dhe masat konkrete që parashikon kjo Strategji, organizohen dhe synojnë të adresojnë tri çështje kryesore në përballje me krimin e organizuar dhe krimet e rënda: 1. **Goditja** (*pursue*); 2. **Parandalimi** (*prevention*); 3. **Mbrojtja** (*protection*).

Me gjithë përparimin e bërë, sfida kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda mbetet e madhe dhe për këtë arsye kjo Strategji e rishikon qasjen në përballjen me të. Duke marrë në konsideratë natyrën komplekse dhe gjithmonë në zhvillim të strukturave, veprimtarive dhe formave të shfaqjes së krimit të organizuar, në themel të kësaj strategjie parashikohet një qasje

gjithëpërfshirëse e gjithë shoqërisë shqiptare kundër këtij fenomeni, ku institucionet shtetërore, sektori privat, komunitetet dhe qytetarët të luajnë rolin e tyre në një përpjekje kolektive për të ulur kërcënimin dhe ndikimin e krimit të organizuar. Për të realizuar këtë qëllim, Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 parashikon tri politika:

Me qëllim të uljes së kërcënimit të krimit të organizuar dhe të krimeve të rënda, nevojitet adresimi njëkohësisht i shqetësimeve kryesore që lidhen me veprimtaritë e paligjshme të krimit të organizuar, sidomos atyre në fushën e narkotikëve dhe trafikeve të paligjshme, si dhe veprave penale në fushën e krimit ekonomik dhe pastrimit të parave. Sigurisht, goditja dhe ndjekja e strukturave të krimit të organizuar, të cilat veprojnë brenda apo jashtë vendit është me rëndësi kritike për zbatimin efektiv të kësaj politike.

Përbushja me efektivitet e objektivave të mësipërm do të mbështetet përmes vënies në përdorim të kapaciteteve dhe aftësive të reja për dobësimin e përhapjes dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, duke përmirësuar sistemet, kuadrin ligjor, burimet njerëzore dhe nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit të institucioneve dhe aktorëve vendës me përgjegjësi dhe rol në këtë fushë. Për më tepër, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet nevojës për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, kapjes dhe vënies përpara drejtësisë të personave në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar dhe zbatimit të regjimit të posaçëm në burgun e sigurisë së lartë për subjektet me rrezikshmëri të theksuar kriminale.

Objektivi specifik 1.1: Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve

Lufta kundër narkotikëve do të intensifikohet, duke bashkërenduar angazhimin e institucioneve ligjzbatuese me atë të vendeve partnere, si dhe do të ndërmerren procese të thella reformuese që do të prekin legjislacionin, logjistikën dhe personelin e institucioneve.

Në themel të kësaj qasjeje do të jenë mbledhja dhe analizimi i të dhënave të reja, rritja e aftësive informative dhe të vlerësimit, të cilat do t'u mundësojnë institucioneve të zbatimit të ligjit dhe qeverisë të kuptojë më mirë organizimin dhe veprimtarinë e rrjeteve të krimit të organizuar, avantazhet dhe dobësitë e tyre, me qëllim realizimin e goditjeve sa më efektive. Për shkak se grupet dhe rrjetet kriminale shqiptare tashmë operojnë në një kontekst pothuaj tërësisht transnacional, edhe qasja gjurmuese dhe goditëse do t'i përshtatet kësaj prirjeje, duke thelluar cilësisht bashkëpunimin me institucionet ligjzbatuese të vendeve evropiane, ku grupet shqiptare të krimit të organizuar operojnë.

Ulja e kërcënimeve dhe e ndikimit negativ që shkaktohet nga veprimtari të paligjshme në fushën e narkotikëve do të mbështetet në realizimin e masave dhe aktiviteteve të mëposhtme:

- rritja e veprimtarisë zbuluese të udhëhequr nga inteligjenca dhe evidencat;
- përditësimi i bazës së të dhënave të posaçme për kultivimin e kanabisit me informacione nga të gjitha burimet e mundshme vendëse dhe të huaja;
- planifikimi, organizimi dhe realizimi i takimeve, analizave dhe operacioneve të përbashkëta me qëllim rritjen e zbulimit, hetimit, ndjekjes penale, dënimit dhe sekuestrimit në këtë drejtim;
- ngritja dhe funksionimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm;
- ngritja dhe funksionimi i Observatorit Kombëtar të Drogave;
- magazinimi dhe asgjësimi i lëndëve narkotike dhe prekursorëve, dhe ruajtja e mostrave si provë materiale për procedurat gjyqësore sipas standardeve dhe praktikave më të mira;
- forcimi i kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit ndërkombëtar të drogave;
- rritja e efikasitetit të bashkëpunimit me partnerët në drejtim të zbulimit të veprimtarive të paligjshme dhe të goditjes së strukturave kriminale;
- përmirësimi i kuadrit legjislativ për substancat psikotrope dhe prekursorët dhe përditësimi i listës së substancave të ndaluara psikoaktive;
- përmirësimi i kuadrit legjislativ mbi procedurën e asgjësimit të lëndëve narkotike dhe prekursorëve, dhe ruajtjes së mostrave.

Objektivi specifik 1.2: Goditja e trafikeve të paligjshme

Një vëmendje e veçantë në këtë Strategji i kushtohet, gjithashtu, uljes së kërcënimit që vjen nga veprimtaritë e paligjshme në fushën e trafikëve, duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore, ndihmën për kalim të paligjshëm të kufirit apo e njohur ndryshe si kontrabandimi i migrantëve, trafikimi i armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse, trafikimi i veprave të artit dhe pasurive kulturore etj. Lidhur me këtë, masa dhe veprimtari shtesë do të parashikohen dhe ndiqen mbi bazë të planit shoqërues të veprimit.

Ulja e kërcënimeve dhe e ndikimit negativ që shkaktohet nga veprimtari të trafikëve të paligjshme do të mbështetet në realizimin e masave dhe aktiviteteve të mëposhtme:

- rritja e veprimtarisë zbuluese ndaj trafikëve të paligjshme të udhëhequr nga intelijenca dhe evidencat;
- planifikimi, organizimi dhe realizimi i takimeve, analizave dhe operacioneve të përbashkëta, me qëllim rritjen e zbulimit, hetimit, ndjekjes penale, dënimit, sekuestrimeve dhe konfiskimeve në këtë drejtim;
- forcimi i bashkëpunimit me partnerët në drejtim të zbulimit të veprimtarive të paligjshme të trafikëve dhe të goditjes së strukturave kriminale të përfshira në këto veprimtari;
- përmirësimi dhe miratimi i procedurave dhe i mekanizmave standardë kundër trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta;
- hartimi dhe miratimi i planit kombëtar të veprimit “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të luajtshme”;
- forcimi i kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit ndërkombëtar të pasurive kulturore;
- ngritja dhe funksionimi i Task-Forcës Ndërinstitucionale për ruajtjen dhe luftën kundër vjedhjes dhe trafikimit të Pasurive Kulturore;
- formalizimi i tregut dhe monitorimi i qarkullimit civil dhe fizik të pasurive kulturore;
- plotësimi i kuadrit ligjor vendës, në përputhje me instrumentet ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;
- sigurimi i aksesit dhe ndërveprimi i sistemeve dhe i bazave të të dhënave shtetërore, që administrohen nga Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Kulturës (Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore), me qëllim evidentimin, gjurmimin, parandalimin, monitorimin dhe ndalimin në kohë të rasteve dhe personave që lidhen me trafikimin e paligjshëm të pasurive kulturore;
- ratifikimi i konventave në fushën e trashëgimisë kulturore ende të paratifikuara nga shteti shqiptar, si Konventa UNIDROIT, Konventa e BE “*Council of Europe Convention on Offences relating to Cultural Property, Nicosia 2017*”;
- kryerja e trajnimeve të stafit në çdo pikë të kontrollit kufitar lidhur me përdorimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri Kombëtar i Pasurive Kulturore”.

Objektivi specifik 1.3: Goditja e krimit ekonomik të pastrimit të parave

Zbatimi i kësaj politike do të mbështetet, gjithashtu, përmes përmirësimit të proceseve të identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të financave dhe aseteve të grupeve kriminale. Kjo do të ngushtojë hapësirën e veprimit, fuqisë financiare, por dhe motiveve të përfshirjes në struktura të krimit të organizuar, si dhe pamundësimin e riinvestimit të të ardhurave të përfutuara nga veprimtari të paligjshme. Goditja e krimit ekonomik dhe e pastrimit të parave përbën një nga shtyllat kryesore në luftën kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimi i gjerë institucional dhe me vendet partnere do të jetë një domosdoshmëri për përmbushjen e këtij objekti.

Ulja e kërcënimeve dhe e ndikimit negativ që shkaktohet nga veprimtari të krimit ekonomik dhe pastrimit të parave do të mbështetet në realizimin e masave dhe aktiviteteve të mëposhtme:

- forcimi i kapaciteteve të specializuara qendrore dhe vendore për hetimin e krimit ekonomik dhe financiar, duke përfshirë kryerjen e trajnimeve të përbashkëta;

- sigurimi i aksesit dhe ndërveprimi *online* i bazave të të dhënave në funksion të mbikëqyrjes dhe të hetimit në fushën ekonomike-financiare;
- koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional, me qëllim rritjen e numrit të informacioneve të shkëmbyera mes strukturave përgjegjëse dhe kryerjen e analizave të thelluara mbi risqet e pastrimit të parave dhe administrimin e të dhënave (*track record*);
- përmirësimi i zbatimit të sanksioneve financiare të targetuara dhe rritja e hetimeve financiare proaktive dhe paralele që nga fillimi i procedimeve penale;
- rritja e sekuestimeve dhe e konfiskimeve mbështetur në inteligjencë dhe hetime cilësore të thelluara;
- rishikimi dhe miratimi i kuadrit legjislativ mbi gjurmimin, sekuestrimin, konfiskimin dhe rikuperimin e produkteve të krimit të organizuar;
- menaxhimi i pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, duke ruajtur vlerën ekonomike të tyre.

Objektivi specifik 1.4: Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i drejtuesve dhe i anëtarëve të strukturave kriminale

Krijimi i strukturave të reja në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda është tepër shpresëdhënës, për sa i përket goditjes së grupeve të krimit të organizuar dhe dënimit të drejtuesve dhe anëtarëve të tyre. Me qëllim arritjen e rezultateve pozitive në këtë front do t'i kushtohet një vëmendje e veçantë rritjes së efikasitetit të hetimeve kundër strukturave të organizuara kriminale, sidomos drejtuesve dhe financuesve të veprimtarive kriminale. Nëpërmjet forcimit të kapaciteteve teknike dhe investimeve në funksion të hetimeve të thelluara, cilësore dhe proaktive, si dhe pasurimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor, do të synohet rritja e eficiencës në luftën kundër strukturave të krimit të organizuar.

Në funksion të hetimit penal dhe të dënimit të drejtuesve dhe të anëtarëve të strukturave të organizuara kriminale do të ndiqen dhe do të zbatohen masat dhe aktivitetet e mëposhtme:

- rritja e efikasitetit të hetimeve kundër strukturave të organizuara kriminale, sidomos drejtuesve dhe financuesve të veprimtarive kriminale;
- zgjerimi i aksesit dhe ndërveprimi i bazave të të dhënave publike/private të aksesueshme nga autoritetet përgjegjëse dhe zhvillimi dhe përdorimi i zgjeruar i kapaciteteve analitike (*software*);
- blerje pajisjesh për Policinë Shkencore;
- hartimi i projekteve, përthithja e financimeve dhe koordinimi i projekteve për mbështetjen e kapaciteteve njerëzore, infrastrukturore dhe logjistike të agjencive të zbatimit të ligjit;
- blerje pajisjesh dhe asistencë teknike për strukturat e Policisë së Shtetit, në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike dhe krimit të organizuar;
- zbatim i regjimit të posaçëm në burgun e sigurisë së lartë;
- rritja e hetimeve ndaj metodave dhe rasteve të infiltrimit (korrupsioni, kërcënimet etj.) nga strukturat e krimit të organizuar.

Objektivi specifik 1.5: Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar

Krimi i organizuar është një sfidë që i kalon kufijtë e territorit shqiptar. Shumë grupe kriminale shqiptare e ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendet e Bashkimit Evropian dhe më gjerë. Për këtë arsye nevojitet një bashkëpunim i shkëlqyer ndërmjet institucioneve shqiptare me ato partnere. Nëpërmjet pjesëmarrjen aktive në Europol, në Interpol dhe në platformat rajonale të bashkëpunimit, do të rritet shkëmbimi i informacionit mbi strukturat kriminale brenda dhe jashtë vendit, çka do të rezultojë në më shumë operacione të përbashkëta policore kundër veprimtarive dhe strukturave kriminale.

Me qëllim të forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar midis agjencive të zbatimit të ligjit, si një element kyç për luftën e suksesshme kundër veprimtarive dhe anëtarëve të strukturave të organizuara kriminale do të ndiqen dhe zbatohen masat dhe aktivitetet e mëposhtme:

- rritja e shkëmbimit të informacionit me agjencitë ligjzbatuese të vendeve të rajonit dhe më gjerë mbi strukturat kriminale brenda dhe jashtë vendit;

- pjesëmarrja aktive në Europol, në Interpol dhe në platformat rajonale të bashkëpunimit;
- nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve me vendet e tjera për shkëmbimin e të dhënave (gjurmë daktiloskopike, profile ADN, të dhëna automjetesh, rekorde kriminale, të dhëna financiare etj.);

- rritja e operacioneve të përbashkëta policore kundër veprimtarive dhe strukturave kriminale.

Objektivi specifik 1.6: Kapja e personave në kërkim ndërkombëtar

Ky objektivi specifik lidhet drejtpërdrejt me konsolidimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese të vendeve partnere. Që prej vitit të kaluar Shqipëria krijoi një njësi speciale, e cila do të merret me vetëm me ndalimin e personave të shpallur në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo njësi i është bashkuar rrjetit ENFAST, e cila është ombrellë e njësisë speciale të disa vendeve evropiane. Njëpërmjet trajnimeve dhe pjesëmarrjes aktive në takimet e FAST-it, do të synohet rritja e numrit të shtetasve shqiptarë dhe të huaj në kërkim ndërkombëtar të lokalizuar dhe arrestuar.

Gjetja, gjurmimi, kapja dhe vënia përpara përgjegjësisë ligjore të personave në kërkim kombëtar dhe ndërkombëtar, krahas zbatimit të ligjit, përbën një aspekt të rëndësishëm të uljes së ndikimit dhe të kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, për vendin tonë dhe më gjerë. Për vazhdimin dhe forcimin e rezultateve të arritura deri më tani në këtë drejtim do të ndiqen dhe do të zbatohen masat dhe aktivitetet e mëposhtme:

- pjesëmarrja aktive në takimet dhe trajnimet e ENFAST-it;
- rritja e shkëmbimit të të dhënave me vendet anëtare të ENFAST-it, Europolit dhe Interpolit;
- rritja e numrit të shtetasve shqiptarë dhe të huaj në kërkim ndërkombëtar të lokalizuar dhe arrestuar;

- publikimi dhe përditësimi i të dhënave të identitetit të personave në kërkim ndërkombëtar.

Objektivi specifik 1.7: Forcimi i marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja

Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në procesin penal është një nga format më thelbësore të bashkëpunimit midis shteteve në sfidat që lidhen me aktivitetet kriminale dhe personave të përfshira në to. Globalizmi dhe lëvizja e lirë e njerëzve e shtetasve paraqet sfida të përbashkëta në fushën e sigurisë, të cilat nuk mund të zgjidhen brenda një territori juridiksional, por parashtron si kusht bashkëpunimin ndërkufitar. Kjo Strategji do të synojë rritjen e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja si kundërpërgjigje e atyre personave që tentojnë t'i shpëtojnë ndëshkimit të ligjit, si dhe si rrjedhojë rritjen e besimit të ndërsjellë me vendet e tjera.

Me qëllim të forcimit të mëtejshëm të rezultateve të drejtësisë penale ndaj autorëve dhe veprimtarive të paligjshme të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, nevojitet përdorimi sa më i plotë i instrumenteve dhe i mekanizmave ndërkombëtarë në nivel juridiksional. Për këtë qëllim do të ndiqen dhe zbatohen masat dhe aktivitetet e mëposhtme:

- rritja e efikasitetit të bashkëpunimit gjyqësor, në raport me minimizimin e kohës për ekzekutimin e kërkesave për bashkëpunim gjyqësor ndërkombëtar nga Shqipëria apo nga shtetet e huaja;

- përditësimi dhe aksesimi në regjistrin gjyqësor penal të shtetasve shqiptarë të dënuar jashtë shtetit;

- mbështetja dhe rritja e pjesëmarrjes në skuadrat e përbashkëta hetimore (JIT-s dypalëshe/Eurojust).

2.2. Qëllimi i politikës II: Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë

Si rezultat i veprimtarisë së krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, ndër vite, shumë qytetarë kanë vuajtur pasojat e kësaj veprimtarie në forma të ndryshme, si trafikimi për qëllime prostitucioni apo pune të detyruar, zhvatja e vlerave monetare apo materiale, dëmtimi i pronës dhe i pasurisë dhe deri në dëmtimin e shëndetit dhe humbjen e jetës. Anëtarët e strukturave të krimit të organizuar kanë shfaqur, gjithashtu, synimin dhe prirjen për veprime neutralizuese të punës së nëpunësve publikë, përfshirë institucionet e zbatimit të ligjit dhe të organeve të drejtësisë, përmes formave të ndryshme të intimidimit dhe të korrupsionit.

Për më tepër, krimi i organizuar ka ndikim negativ në ekonominë e ligjshme të një vendi. Nëpërmjet përfitimeve të mëdha monetare, grupet kriminale synojnë të kryejnë investime dhe depërtojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë nëpërmjet formave të ndryshme të pastrimit dhe të riciklimit të të ardhurave kriminale, prezantimin e praktikave gjysmë të ligjshme të biznesit dhe krijimin e aktiviteteve të ligjshme për të mbuluar veprimtaritë e fshehta kriminale dhe origjinën e të ardhurave të përfutuara prej tyre, dëmtimin e konkurrencës etj. Për sa më sipër, ulja e kërcënimit dhe ndikimit negativ të krimit të organizuar mbi qytetarët, institucionet dhe ekonominë e ligjshme të vendit, si dhe mbrojtja e tyre nga këto kërcënime vlerësohet si politikë e veçantë e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda.

Objektivi specifik 2.1: Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'ju nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar

Në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, agjencitë ligjzbatuese duhet të jenë të afta të garantojnë shëndetin dhe jetën e dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve, funksionarëve të drejtësisë, viktimave të trafikimit dhe grupe të tjera vulnerabël. Në këtë mënyrë do të rritet besimi i njerëzve në institucionet shtetërore dhe do të forcohet marrëdhënia shtet-qytetar.

Për një luftë më efektive kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda është e nevojshme që të garantohet, së pari, siguria fizike dhe e jetës së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, funksionarëve të drejtësisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit, si dhe viktimave të krimit, përfshirë ato të trafikimit. Për përmbushjen e këtij objekti duhet të zbatohen masat e mëposhtme:

- garantimi i jetës dhe sigurisë fizike të dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë, funksionarëve të ngarkuar me luftën kundër krimit të organizuar dhe viktimave të trafikimit përmes programeve të posaçme;
- nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare mbi programet e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë;
- ofrimi i asistencës ndaj viktimave të trafikimit.

Objektivi specifik 2.2: Rritja e profesionalizmit

Krahas garantimit të integritetit, rritja e profesionalitetit në agjencitë ligjzbatuese do të marrë rëndësi të veçantë në zbatimin e kësaj Strategjie. Do të kryhen trajnime të përbashkëta nga strukturat e hetimit të krimit në Policinë e Shtetit, punonjësve të agjencive ligjzbatuese, shërbimeve inteligjente dhe funksionarëve të drejtësisë në funksion të hetimeve të thelluara dhe cilësore, ndjekjes penale, si dhe dënimit të autorëve. Kjo do të sjellë jo vetëm rritjen e ekspertizës, por edhe konsolidimin e frymës së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shqiptare.

Përmirësimi i mëtejshëm dhe i vazhdueshëm i kapaciteteve profesionale përbën kusht për një përgjigje sa më efektive ndaj formave të ndryshme të shfaqjes së krimit të organizuar, përfshirë ato më komplekse dhe zbulimin, hetimin dhe dënimin e autorëve të tyre, të cilët përdorin gjithnjë e më shumë metodat dhe taktika të zhvilluara për t'iu shmangur veprimtarisë zbuluese dhe hetimore të agjencive të zbatimit të ligjit, me synimin përfundimtar për t'iu shmangur përgjegjësisë penale. Për përmbushjen e këtij objekti kërkohet zbatimi i masave të mëposhtme:

- kryerja e trajnimeve të strukturave të hetimit të krimit në Policinë e Shtetit mbi format dhe metodat më të avancuara të hetimit të strukturave dhe veprimtarive kriminale;
- kryerja e trajnimeve të përbashkëta për punonjësit e agjencive të zbatimit të ligjit, shërbimeve inteligjente dhe funksionarëve të drejtësisë në funksion të hetimeve të thelluara dhe cilësore, ndjekjes penale, dënimit të autorëve dhe sekuestrimit/konfiskimit të produkteve dhe aseteve kriminale;
- kryerja e trajnimeve për punonjësit e agjencive të zbatimit të ligjit, gjyqtarëve dhe prokurorëve mbi rolin e viktimave në drejtësinë penale;
- pranimi në Akademinë e Sigurisë i të diplomuarve që kanë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë.

Objektivi specifik 2.3: Dobësimi i motivit financiar në përfshirje në krim të organizuar

Ky objektiv do të përqendrohet kryesisht në analizimin e legjislacionit, politikave dhe rolit të institucioneve në funksion të masave me karakter ekonomik dhe pasuror. Nëpërmjet këtij aktiviteti synohet evidentimi i mangësive dhe i nevojave për t'u përmirësuar më pas në legjislacion. Në këtë kuadër do të ndërmerren ndryshime ligjore dhe nënligjore në funksion të rritjes së parandalimit të investimit të të ardhurave kriminale në ekonomi. Gjithashtu, kryerja e trajnimeve në këtë fushë do të mundësojë zbatimin më eficient të masave parandaluese pasurore.

Mbrojtja e ekonomisë së ligjshme nga mundësitë dhe hapësirat e shfrytëzueshme nga strukturat e krimit të organizuar, me qëllim riciklimin e të ardhurave me origjinë kriminale, përbën një aspekt të rëndësishëm të qasjes mbrojtëse kundër kërcënimeve dhe ndikimit negativ të krimit të organizuar në shoqëri. Zbatimi në praktikë i qasjes administrative kundër krimit të organizuar ka rezultuar efikas për agjenci të ndryshme të zbatimit të ligjit. Ndjekja dhe forcimi i zbatimit të kësaj qasje në vendin tonë do të realizohet përmes masave të mëposhtme:

- analizë e legjislacionit, politikave dhe rolit të institucioneve dhe agjencive të zbatimit të ligjit, në funksion të masave parandaluese me karakter ekonomik dhe pasuror;
- evidentimi i mangësive dhe i nevojave për përmirësim të kuadrit ligjor parandalues;
- hartimi dhe miratimi i ndryshimeve ligjore dhe nënligjore në funksion të rritjes së parandalimit të investimit të të ardhurave kriminale në ekonomi;
- kryerja e trajnimeve, analizave dhe koordinimi ndërinstitucional në zbatim të masave parandaluese pasurore.

2.3. Qëllimi i politikës III: Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda

Strukturat dhe rrjetet e krimit të organizuar synojnë dhe angazhohen në mënyrë të vazhdueshme për të rekrutuar anëtarë të rinj për kryerjen dhe zgjerimin e mëtejshëm të veprimtarive kriminale.

Për shkak të vështirësive me karakter kryesisht social-ekonomik, aftësia e strukturave kriminale për të rekrutuar anëtarë të rinj ka qenë e lartë, siç dëshmojnë dhe të dhënat statistikore të shtrira në kohë, mbi profilin e autorëve të dënuar për veprimtari të tilla kriminale, si brenda dhe jashtë vendit.

Kjo politikë mbështetet mbi vizionin e qeverisë shqiptare për adresimin gjithëpërfshirës të fenomeneve të paligjshme, përfshirë kërcënimet dhe ndikimin negativ të krimit të organizuar, duke mos u kufizuar vetëm në qasjen goditës dhe mbrojtëse. Qasja parandaluese (*prevent*) kërkon kohën e nevojshme dhe angazhimin e të gjithë aktorëve në shoqëri, përtej institucioneve shtetërore, për të ofruar rezultate të qëndrueshme dhe efektive në uljen e kërcënimeve dhe ndikimit të krimit të organizuar. Kjo politikë mbështetet në nevojën për rritjen e vetëdijësisë, ndjenjës së përgjegjësisë së përbashkët për sigurinë në komunitet, besimit të qytetarëve dhe bashkëpunimit të tyre me institucionet në përgjigje të përpjekjeve dhe formave të shfaqjes së veprimtarive të paligjshme. Gjithashtu, ofrimi i alternativave zhvillimore për komunitetet dhe zonat më të ndikuara dhe ekspozuara ndaj veprimtarive të paligjshme dhe përpjekjeve rekrutuese të strukturave të krimit të organizuar përbën njëkohësisht një aspekt me rëndësi kritike për zbatimin me sukses të qasjes parandaluese. Konkretisht, kjo politikë do të përmbushet përmes realizimit të masave dhe aktiviteteve të mëposhtme:

Objektivi specifik 3.1: Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësisë me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar

Sfidat që lidhen me krimin e organizuar dhe aktivitetet kriminale në tërësi nuk mund të përballen vetëm me qasje konfrontative dhe robuste, por paralelisht duhet të punohet me ndërgjegjësimin e publikut, duke përfshirë këtu të gjithë aktorët relevantë që kanë një ndikim të gjerë si institucionet qendrore dhe vendore, shoqëria civile, biznesi, media etj.

Në këtë drejtim janë ndërmarrë disa hapa nga institucionet shqiptare. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si rezultat i një marrëveshjeje ndërinstitucionale me Ambasadën Britanike në Tiranë momentalisht po harton një paketë mësimore (modul) mbi krimin e organizuar dhe krimet e rënda.

Kjo marrëveshje synon implementimin e një pakete mësimore/kurrikulare rreth parandalimit të krimit të organizuar dhe krimet e rënda në disa rajone dhe shkolla pilot në Republikën e Shqipërisë.

Mbi këtë modul fillimisht do të trajnohen nga MASR-ja dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) mësuesit që japin lëndën “Qytetari” në disa institucione arsimore parauniversitare të përzgjedhura për pilotim. Këta mësues do të mësojnë më pas nxënësit nën monitorimin e grupit trajnues. Ky projekt synon të zgjerohet më tej në të gjitha shkollat e vendit. Në kuadër të këtij projekti janë realizuar edhe aktivitete sensibilizuese me nxënësit të grup-moshës nga 13–18 vjeç.

Në funksion të përmbushjes së objektivit të parë specifik të kësaj politike do të zbatohen masat e mëposhtme:

- organizimi i fushatave ndërgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, me grupe të targetuara dhe tema të përshtatura me kontekstin vendor lidhur me risqet, pasojat dhe parandalimin e përfshirjes në veprimtari kriminale;
- organizimi i leksioneve dhe seminareve të hapura në institucione arsimore publike dhe private;
- realizimi i video-mesazheve ndërgjegjëse mbi risqet dhe pasojat e krimit të organizuar, si dhe promovimi i modeleve pozitive ndërmjet të rinjve dhe transmetimi në mediet lokale, rrjete sociale etj.;
- organizimi i takimeve të këshillave vendorë për sigurinë publike me të ftuar nga shoqëria civile, të rinj, aktorë kyç në komunitete me fokus rritjen e vetëdijësisë ndaj krimit të organizuar.

Objektivi specifik 3.2: Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël

Një sfidë e veçantë, në kuadër të kësaj Strategjie do të jetë ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme dhe të huaj për zonat dhe komunitetet vulnerabël. Si hap të parë Strategjia parashikon evidentimin dhe analizimin e këtyre zonave dhe komuniteteve, për të koordinuar dhe nxitur më pas vënien në jetë të programeve dhe projekteve sociale, dhe financiare, me qëllim parandalimin e kriminalitetit. Më tej do të bëhen përpjekje serioze për nxitjen e programeve sociale me fokus shtresat në nevojë. Gjithashtu do të nxitet kalimi i objekteve të konfiskuara në pronësi të njëjësive të qeverisjes vendore, me qëllim përdorimin si banesa sociale.

Në funksion të përmbushjes së objektivit të dytë specifik të kësaj politike do të zbatohen masat e mëposhtme:

- evidentimi dhe analizimi i zonave gjeografike, komuniteteve dhe grupeve shoqërore të afektuara dhe vulnerabël ndaj strukturave dhe veprimtarive të paligjshme;
- nxitja e programeve sociale me fokus shtresat në nevojë dhe viktimat e krimit përmes projekteve të financuara nga Fondi i Posaçëm për parandalimin e kriminalitetit;
- nxitja e kalimit të objekteve të konfiskuara në pronësi të njëjësive të qeverisjes vendore me qëllim përdorimin si banesa sociale.

PJESA III

ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

3.1 Përgjegjësia e institucioneve

Institucionet përgjegjëse që ngarkohen për zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe Planit të Veprimit janë:

1. Ministria e Brendshme;
2. Ministria e Drejtësisë;
3. Ministria e Mbrojtjes;
4. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
5. Ministria e Kulturës;
6. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

7. Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
8. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
9. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
10. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
11. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
12. Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;
13. Këshilli i Lartë Gjyqësor;
14. Prokuroria e Përgjithshme;
15. Shërbimi Informativ i Shtetit;
16. Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kombëtare;
17. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
18. Banka e Shqipërisë.

3.2. Llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi

Llogaridhënia

Përqasja dhe rishikimi i dokumentit Strategjik do të jetë sipas kërkesave të VKM-së nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me sistemin IPSIS”.

Procesi i llogaridhënies, monitorimit dhe analizës vlerësuese do të bëhet nga strukturat koordinuese si më poshtë:

Grupi i menaxhimit të integruar të politikave (GMIP);

- Komiteti Drejtues Sektorial (KDS) për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, i cili do të shqyrtojë dhe do të miratojë raportet në zbatim të politikave dhe objektivave të përcaktuar në këtë dokument strategjik.

- Ministria e Brendshme është institucioni përgjegjës që udhëheq hartimin, koordinimin dhe bashkërendimin e institucioneve të përfshira në këtë Strategji.

Monitorimi

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Strategji dhe në planin e veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara për përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga këto dokumente konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale gjatë zbatimit të tyre dhe për të mbikëqyrur implementimin periodik, me qëllim përmbushjen e tyre në mënyrë sa më efektive.

Monitorimi dhe vlerësimi i punës së autoriteteve që kanë detyrime për zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e Strategjisë, për të vlerësuar shkallën e realizimit të politikave, objektivave të saj dhe përmbushjes së masave dhe aktiviteteve.

Monitorimi i Planit të Veprimit do të kryhet nga grupi për menaxhimin e integruar të politikave (GMIP), të miratuar me urdhrin e kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

Procesi do të kryhet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga institucionet kryesore përgjegjëse për çështjet e sigurisë (përfshirë MB/DPPSH, MD, MASR, MSHMS etj.), donatorë dhe shoqëria civile (përfaqësues të organizatave joqeveritare).

Me synim garantimin e përmbushjes së politikave në luftën kundër krimit të organizuar, bazuar në këtë dokument strategjik, do të merren masat e mëposhtme:

- do të monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji;
- do të rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat, risqet dhe rreziqet, si dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet e progresraporteve të Bashkimit Evropian;
- do të sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;

- do të jepet kontribut në rritjen e konsistencës dhe të integritetit të politikave dhe masave të sigurisë në të gjitha nivelet e administrimit, si dhe në përdorimin më të mirë të burimeve.

Monitorimi do të kryhet bazuar në raporte 6-mujore dhe vjetore për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave dhe masave të planit të veprimit.

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioritetëve në fusha të ndryshme dhe të informojnë për politikën e vendit të lidhura me përballjen e sfidave kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Fuqizimi dhe zgjerimi i kuadrit statistikor si në MB, DPPSH-ja dhe institucionet e tjera përgjegjëse do të lehtësojë hartimin e politikave bazuar në evidenca/të dhëna, si dhe do të mundësojë vlerësimin objektiv për përmbushjen e objektivave.

Raportimi

Të gjitha institucionet të ngarkuara me zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe planit të veprimit do të hartojnë raporte mbi bazë 6-mujore dhe njëvjeçare në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit në zbatim të Strategjisë, si dhe do të hedhin të dhëna në sistemin IPSIS.

Ministria e Brendshme do të jetë institucioni lider, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike 6- mujore dhe 1-vjeçare që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara në përmbushje të objektivave dhe masave përkatëse.

Institucionet duhet të raportojnë periodikisht për realizimin e masave, me periodicitet 6-mujor përmes të dhënave të raportuara në Sistemin Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS) në Këshillin e Ministrave dhe në Sekretariatën Teknik Ndërinstitucional.

Komiteti Drejtues Sektorial “Punët e brendshme”, drejtuar nga Ministri i Brendshëm, në zbatim të pikave 6 dhe 7, të urdhrit të kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, do të shqyrtojë, diskutojë dhe miratojë raportet e progresit, të monitorimit të arritjes së synimeve dhe prioritetëve në zbatim të këtij dokumenti strategjik dhe planit të veprimit.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm, progresi në përmbushjen e qëllimeve të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të matet nëpërmjet dy mënyrave të vlerësimit, atë të vlerësimit afatmesëm, që do të kryhet në përfundim të dyvjeçarit, në fund të vitit 2022, që do të analizojë rezultatet e arritura, menaxhimin e burimeve dhe cilësinë e zbatimit. Kjo analizë do të tregojë për ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm ekonomik dhe social, do të vlerësojë nëse qëllimet janë të qenësishme, duke krahasuar kontekstin fillestar dhe do të identifikojë veprimet e nevojshme.

Bazuar në këtë vlerësim, do të hartohet Plani i Veprimit për vitet 2023–2025 për të arritur objektivat e vendosur në strategji.

Një vlerësim përfundimtar, pas përfundimit të periudhës së zbatimit, do të analizojë të gjithë strategjinë dhe ndikimin e saj të përgjithshëm, ku do të vlerësohen rezultatet e masave të ndërmarra, burimeve të investuara dhe masën në të cilën janë arritur efektet e pritura. Vlerësimi përfundimtar do të kryhet duke analizuar të dhënat nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe gjetjet e monitorimit të performancës dhe vlerësimit të ndikimit të programeve aktive në luftën kundër krimit të organizuar.

PJESA IV

ANALIZA BUXHETORE

(zëvendësuar me VKM nr. 54, datë 1.2.2023)

4.1 Analiza e treguesve buxhetor për zbatimin e Strategjisë

Ky kapitull përshkruan shpërndarjen në vija të përgjithshme të burimeve financiare që financojnë produktet e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025. Efektet financiare janë përlogaritur nga çdo institucion bazuar në implementimin e aktiviteteve të masave përkatëse që janë të parashikuara në Planin e Veprimit të kësaj strategjie. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara, si dhe nga buxheti i donatorëve për zbatimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021–2025 dhe planit të veprimit 2023–2025, në mënyrë të detajuar.


Procesi i kostimit është bazuar në konsultimin e dokumenteve kombëtare, përfshirë këtu Programi Buxhetor Afatmesëm, 2023–2025, si dhe konsultimet me institucionet e përfshira. Planin e veprimit është shoqëruar me një kostim analitik të secilës masë.

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur e planit të veprimit për zbatimin e kësaj Strategjie për periudhën trevjeçare 2023–2025 është 11,864,032,792 lekë ose 96,455,551 euro. Kursi mesatar për referencë është përlogaritur me 123 lekë për 1 euro.


Qëllimi i politikës I pritët të ketë në terma financiarë peshën më të madhe në zbatimin e planit, përkatësisht 81%. Qëllimi i politikës II do të arrijë vlerën 14%, ndërsa qëllimi i politikës III do të arrijë vlerën 5%. Më poshtë, gjendet pasqyrimi i kostove financiare përgjatë 3 vjetëve të zbatimit të Planit të Veprimit të kësaj Strategjie.

Qëllimi i politikave	Natyra/ tipologjia e kostove	Kostoja totale 2023–2025	Kostot e planifikuara PBA 2023–2025 Buxheti dhe donatorët	Hendeku financiar 2023–2025
Qëllimi i politikës I	Korrente	7,929,986,810	7,929,986,810	0
	Kapitale	1,633,079,131	1,633,079,131	0
Qëllimi i politikës II	Korrente	1,695,433,351	1,695,433,351	0
	Kapitale	0	0	0
Qëllimi i politikës III	Korrente	605,533,500	605,533,500	0
	Kapitale	0	0	0
TOTALI [lek]		11,864,032,792	11,864,032,792	0
TOTALI [euro] <i>1 euro = 123 lekë</i>		96,455,551	96,455,551	0


Financimi i planit të veprimit të Strategjisë do të realizohet nga dy burime kryesore, nga buxheti i shtetit dhe nga mbështetja financiare e donatorëve. Për periudhën 2023–2025, buxheti i shtetit pritët të financojë zbatimin e planit në masën 89% të financimit të nevojshëm, 11% pritët të financohet nga mbështetja e donatorëve të huaj.



Kostot korrente zënë rreth 86%, ndërsa pjesa tjetër prej 14% është e parashikuar për kosto kapitale.



Të ndara sipas qëllimeve të politik, ato pasqyrohen, si më poshtë:



Plani i Veprimit të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda do të rishikohet në periudhë 3-vjeçare për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë konform programeve buxhetore afatmesme, si dhe prioriteteve të çdo institucioni.

PLANI I VEPRIMIT
PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA, 2021–2025
(*zëvendësuar me VKM nr. 54, datë 1.2.2023*)

I. Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit

II. Qëllimi i politikës 1: Ulja e kërcënimit dhe e ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda

III. Programi buxhetor që kontribuon për qëllimin e politikës: Programi 01110, Ministria e Brendshme; Programi 03140, Policia e Shtetit; Programi 1012020, IKRKT-ja; Programi 01110, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Programi 03440, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; Programi 1014001, Ministria e Drejtësisë

Nr.	Titulli	Programi buxhetor	Institucionet përgjegjëse		Afati i Zbatimit		Kostoja indikative/2023			Kostoja indikative/2024			Kostoja indikative/2025			Kostoja indikative totale			Burimi i financimit						Hedhja financiare
		Referenca e rezultateve me produktet e programit buxhetor	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati fillimi	Afati Mbarimi	Korrence	Kapitale	Total Kosto	Korrence	Kapitale	Total Kosto	Korrence	Kapitale	Total Kosto	PBA 2023-2025 (në lekë)			Financim i huaj (në lekë)						
																Korrence	Kapitale	Total BSH	Korrence	Kapitale	Total financim i huaj				
1.1	OBJEKTIVI SPECIFIK: Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e trafikimit				2023	2025																			
	Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e trafikimit																								
1.1.1	Rejta e veprimtarisë shpeshë që shpeshë nga integriteti dhe evidencë në fushën e trafikimit	9160AAA	Policia e Shtetit	PP-PU, ASHM, SHISH, Drogave, ASHM	2023	2025	136,395,300	0	136,395,300	136,395,300	0	136,395,300	136,395,300	0	136,395,300	409,186,300	0	409,186,300	409,186,300	0	409,186,300	0	0		
1.1.2	Prodhimi i huaj të të shpeshë të punëve për kalimtarë e huajve trafikuar me informacione nga të gjitha burimet e mundshme vendore dhe të huaja	9160AAA	Policia e Shtetit	Policia e Shtetit	2023	2025	27,279,100	0	27,279,100	27,279,100	0	27,279,100	27,279,100	0	27,279,100	81,837,300	0	81,837,300	81,837,300	0	81,837,300	0	0		
1.1.3	Rejta e koordinimit administrativ me SPAK, Prokurorin në fushën e operacioneve të përbashkëta, me qëllim të mirës së shpirtit, luftës, ndjekjes penale dhe edukimit në fushën e huajve trafikuar	9160AAA	Policia e Shtetit	Prokuroria Speciale BKSH, Prokuroria e Përgjithshme	2023	2025	8,839,970	0	8,839,970	8,839,970	0	8,839,970	8,839,970	0	8,839,970	26,519,910	0	26,519,910	26,519,910	0	26,519,910	0	0		
1.1.4	Rejta e kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit ndërkombëtar të drogave	9160AAA	Policia e Shtetit	Drejtoria e Përgjithshme e Drogave	2023	2025	143,789,000	0	143,789,000	143,789,000	0	143,789,000	143,789,000	0	143,789,000	431,367,000	0	431,367,000	431,367,000	0	431,367,000	0	0		
1.1.5	Rejta e hetimit prokurativ për veprimtarë në fushën e trafikimit	9160AAA	Policia e Shtetit	Policia e Shtetit	2023	2025	18,452,716	0	18,452,716	18,452,716	0	18,452,716	18,452,716	0	18,452,716	55,358,148	0	55,358,148	55,358,148	0	55,358,148	0	0		
1.1.6	Mosmarrja dhe kontrolli i kontaktit në parandalimin e kalimit të huajve trafikuar	9160AAA 9160AB	Policia e Shtetit	IKSHIT, SHISH, TI	2023	2025	131,452,000	0	131,452,000	131,452,000	0	131,452,000	131,452,000	0	131,452,000	394,356,000	0	394,356,000	394,356,000	0	394,356,000	0	0		
1.1.7	Kerëtyra e një vlerësimi të detajuar mbi Sistemin e Parandalimit të Heksit për shprehjen e informacionit për tubimin e një polimeri	91301AA	MSHIMS	Drejtoria e Përgjithshme e Drogave, ISI, P, ASHM, PSH	2023	2024	215,000	0	215,000	215,000	0	215,000	0	0	0	430,000	0	430,000	430,000	0	430,000	0	0		
	Kostoja, Objektivi specifik 1.1						466,423,280	0	466,423,280	466,423,280	0	466,423,280	466,208,280	0	466,208,280	1,399,054,850	0	1,399,054,850	1,399,054,850	0	1,399,054,850	0	0		
1.2	OBJEKTIVI SPECIFIK: Goditja e trafikave të paligjshme		Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati fillimi	Afati Mbarimi																			
1.2.1	Rejta e veprimtarisë shpeshë ndaj trafikave të paligjshme të shpeshë nga integriteti dhe evidencë	9160AAA	Policia e Shtetit	ASDM, PU, SHISH, Drogave e Përgjithshme e Drogave	2023	2025	546,483,000	0	546,483,000	546,483,000	0	546,483,000	546,483,000	0	546,483,000	1,639,449,000	0	1,639,449,000	1,639,449,000	0	1,639,449,000	0	0		
1.2.2	Rejta e numrit të parandalimit të policisë Kufitare, me qëllim luftës e kontrollimit	9160AAK 90160AAA	Policia e Shtetit	PSH, Drogave e Përgjithshme e Drogave	2023	2025	24,010,000	0	24,010,000	24,010,000	0	24,010,000	24,010,000	0	24,010,000	72,030,000	0	72,030,000	72,030,000	0	72,030,000	0	0		
1.2.3	Rejta e bashkëpunimit me partecet në detyrë të shpeshë të veprimtarisë të paligjshme dhe goditjes së omikurve kriminale në fushën e trafikave të paligjshme dhe trafikimit të qerave speciale	9160AA 9160AAC	Policia e Shtetit	IKRKT, ASHM, PU, SHISH, Drogave e Përgjithshme e Drogave	2023	2025	85,500,000	0	85,500,000	85,500,000	0	85,500,000	85,500,000	0	85,500,000	256,500,000	0	256,500,000	256,500,000	0	256,500,000	0	0		
1.2.4	Rejta e hetimit të Policisë së Shtetit në operacionet kundër trafikimit të armëve të zjarri dhe municioneve	9160AA 9160AAC	Policia e Shtetit	SHISH, Drogave e Përgjithshme e Drogave, ASHM, PU	2021	2022	68,830,000	0	68,830,000	68,830,000	0	68,830,000	68,830,000	0	68,830,000	206,490,000	0	206,490,000	206,490,000	0	206,490,000	0	0		
1.2.5	Rejta e kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit me municione	9160AA 9160AAC	Policia e Shtetit	Drogave e Përgjithshme e Drogave	2023	2025	23,621,000	0	23,621,000	23,621,000	0	23,621,000	23,621,000	0	23,621,000	70,863,000	0	70,863,000	70,863,000	0	70,863,000	0	0		
1.2.6	Rejta e kontrollit kufitar për parandalimin dhe goditjen e trafikimit ndërkombëtar të parave kufitare	9160AAA	Policia e Shtetit	MC, IKRKT	2023	2025	27,401,000	0	27,401,000	27,401,000	0	27,401,000	27,401,000	0	27,401,000	82,203,000	0	82,203,000	82,203,000	0	82,203,000	0	0		
1.2.7	Hetimi dhe shprehja e marrëveshjes të bashkëpunimit me Policinë Kufitare dhe Migracionit dhe Drogave për shprehjen të orkestrimit të informacionit dhe qerave të ndjekjes në bazë e të shpeshë për të forcuar luftën kundër trafikimit të qerave speciale dhe trafikave të paligjshme	91202AB	Policia e Shtetit	Drejtoria e Përgjithshme e Drogave	2023	2025	424,000	0	424,000	424,000	0	424,000	424,000	0	424,000	1,272,000	0	1,272,000	1,272,000	0	1,272,000	0	0		
1.2.8	Prodhimi i municioneve speciale në hetimet prokurativ në luftën kundër krimit të organizuar	94101AB	Policia e Shtetit	PSH, BKSH, Prokuroria e Drogave, PU, SHISH	2023	2025	500,000,000	6,000,000	506,000,000	500,000,000	6,000,000	506,000,000	500,000,000	6,000,000	506,000,000	1,500,000,000	18,000,000	1,518,000,000	1,500,000,000	18,000,000	1,518,000,000	0	0		
1.2.9	Rejta e shprehjes, gjuhëshmërisë dhe ndjekjes penale të krimeve kriminale në punimin e punëve dhe financave të paligjshme	94101AB	Policia e Shtetit	PSH, BKSH, Prokuroria e Drogave, PU, SHISH	2023	2025	30,000,000	0	30,000,000	30,000,000	0	30,000,000	30,000,000	0	30,000,000	90,000,000	0	90,000,000	90,000,000	0	90,000,000	0	0		

1.2.1 0	Hartimi dhe miratimi i Planit Komëtar të Vlerësimit "Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të pasurive kulturore të jashtme", për vitet 2023-2025	91202AB	Instituti Komëtar i regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore	MK Policia e Shtetit	2023	2025	1,404,000	0	1,404,000	1,404,000	0	1,404,000	1,404,000	0	1,404,000	4,212,000	0	4,212,000	4,212,000	0	4,212,000	0	0	0	0
1.2.1 1	Krijimi i detyrës së Objektivit të Hamburg, vënia në funksion e saj, si dhe përditësimi i bazeve të të dhënave dhe Regjistrimit Komëtar të Pasurive Kulturore	91202AB	Instituti Komëtar i regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore	MK	2023	2025	0	212,956,360	212,956,360	0	0	0	0	0	0	0	212,956,360	212,956,360	0	212,956,360	212,956,360	0	0	0	0
1.2.1 2	Hartimi dhe miratimi i një udhëtimi për procedurën e prodhimit të bazeve të të dhënave dhe administrimit të pasurive kulturore të jashtme, në zbatim të pakës të nëntë 130 të ligjit 27/2015	91202AB	Ministria e Kulturës	IKKT	2023	2025	1,404,000	0	1,404,000	1,404,000	0	1,404,000	1,404,000	0	1,404,000	4,212,000	0	4,212,000	4,212,000	0	4,212,000	0	0	0	0
Kontingjencë Objektive specifike 1.2							1,309,077,000	218,956,360	1,528,033,360	1,309,077,000	4,000,000	1,315,077,000	1,309,077,000	4,000,000	1,315,077,000	3,927,231,000	218,956,360	4,158,187,360	3,927,231,000	218,956,360	4,158,187,360	0	0	0	0
1.3	OBJEKTIVI SPECIFIK: Goditja e kimit ekonomik dhe përmirësimi i parave	Referenca e Rezultatit me produktet e programit buxhetor	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontabilizues	Afati fillimi i	Afati mbarimi i																			
1.3.1	Goditja përmes bërësve prodhues në fushën e parimit të parave	91604AA	Policia e Shtetit	PSH PP BKSH DFPFP DPT DFD	2023	2025	28,407,598	0	28,407,598	28,407,598	0	28,407,598	28,407,598	0	28,407,598	85,222,794	0	85,222,794	85,222,794	0	85,222,794	0	0	0	0
1.3.2	Rejta e kapaciteteve të specializuara qëndrore dhe vendore për hetimin e krimeve ekonomike dhe financiare, përfshirë edhe kryerjen e raportave të përshkëlqimit	91604AB	Policia e Shtetit	SHSH DPT DFPD DFPFP QKB	2023	2025	170,256,000	0	170,256,000	0	0	0	0	0	170,256,000	0	170,256,000	170,256,000	0	170,256,000	0	0	0	0	
1.3.3	Koncedimi i praktikave për qëllime të ndihmës në hetimin e krimeve ekonomike, përfshirë edhe kryerjen e raportave të përshkëlqimit	91604AA,91604AR	Policia e Shtetit	PP Policia e Posaqme DFPFP DPT DFD	2023	2025	16,326,675	0	16,326,675	16,326,675	0	16,326,675	16,326,675	0	16,326,675	48,980,025	0	48,980,025	48,980,025	0	48,980,025	0	0	0	0
1.3.4	Rejta e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve në fushën të gjetjes së komponentit në të gjitha format dhe nivelin e shfaqjes	91604AA,91604AR	Policia e Shtetit	DFPFP PP Policia e Posaqme BKSH DPT DFD	2023	2025	11,573,800	0	11,573,800	11,573,800	0	11,573,800	11,573,800	0	11,573,800	34,721,400	0	34,721,400	34,721,400	0	34,721,400	0	0	0	0
1.3.5	Kryerja e bërësve të përshkëlqimit me partnerët për parime të financa të mirënjohura dhe të përditësimit të bazeve të të dhënave	91604AA	Policia e Shtetit	DFPFP PP BKSH Policia e Posaqme	2023	2025	13,738,107	0	13,738,107	13,738,107	0	13,738,107	13,738,107	0	13,738,107	41,214,321	0	41,214,321	41,214,321	0	41,214,321	0	0	0	0
1.3.6	Goditja përmes bërësve prodhues në fushën e kimit ekonomik dhe miratimit financiar	91604AA	Policia e Shtetit	Policia e Posaqme, BKSH PP	2023	2025	15,916,324	0	15,916,324	15,916,324	0	15,916,324	15,916,324	0	15,916,324	47,748,972	0	47,748,972	47,748,972	0	47,748,972	0	0	0	0
1.3.7	Sigurimi i aksesit dhe ndërmjetimi ndërmjet shtetit dhe sektorit privat në fushën ekonomike-financiare	91604AA	Policia e Shtetit	SHSH DPT DFPD DFPFP ASH AEM BSH QKB DIBCA JEL	2023	2025	3,000,000	0	3,000,000	3,000,000	0	3,000,000	3,000,000	0	3,000,000	9,000,000	0	9,000,000	9,000,000	0	9,000,000	0	0	0	0
1.3.8	Goditja përmes bërësve prodhues në fushën e kimit kompjuterik/mashinor që ndodhur nëpërmjet internetit	91604AA	Policia e Shtetit	SHSH DPT DFPD DFPFP BSH	2023	2025	14,052,990	0	14,052,990	14,052,990	0	14,052,990	14,052,990	0	14,052,990	42,158,970	0	42,158,970	42,158,970	0	42,158,970	0	0	0	0
1.3.9	Rejta e shkëmbimeve dhe konfidencës të parave që kanë përjetuar krimeve të shprehura në botën dhe	91604AA	Policia e Shtetit	PP SPAK	2023	2025	14,436,000	0	14,436,000	14,436,000	0	14,436,000	14,436,000	0	14,436,000	43,308,000	0	43,308,000	43,308,000	0	43,308,000	0	0	0	0
1.3.1 0	Kryerja e kompetencave në bazë tëku për subjektin që përbëhet nga ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, të ndërmjetimit	91006AA	DFPFP	Policia e Shtetit	2023	2025	13,521,000	0	13,521,000	13,521,000	0	13,521,000	13,521,000	0	13,521,000	40,563,000	0	40,563,000	40,563,000	0	40,563,000	0	0	0	0
1.3.1 1	Kryerja e analizës të riskut në bashkëpunim me të gjitha institucionet përgjegjëse mbi risqet e parimit të parave dhe administrimit e të dhënave	91604AA	DFPFP	SHSH DPT DFPD DFPFP ASH AEM BSH QKB DIBCA JEL	2023	2025	5,360,000	0	5,360,000	0	0	0	0	0	5,360,000	5,360,000	0	5,360,000	5,360,000	0	5,360,000	0	0	0	0
1.3.1 2	Zgjedhja e aksesit në Baza Qendrore të Monedhave të Falsifikuar nga Policia dhe Policia e Shtetit		Banka e Shqipërisë	Policia e Posaqme e Përgjithshme Ministria e Bërbësimit	2023	2025	193,101	0	193,101	0	0	0	0	0	193,101	0	193,101	193,101	0	193,101	0	0	0	0	
1.3.1 3	Hartimi i praktikave unifikuese për revokimin e shtetit të krimeve të shprehura dhe të dhënave	91601AG	AAPSK	AAPSK	2023	2025	96,000	0	96,000	96,000	0	96,000	96,000	0	96,000	288,000	0	288,000	288,000	0	288,000	0	0	0	0
1.3.1 4	Rejta e kapaciteteve logjistike: Sistemet në zyrë të reja të konfidencës me mjete monetare të konfidencës	91601AH	AAPSK	AAPSK	2023	2023	0	42,471,081	42,471,081	0	0	0	0	0	0	42,471,081	42,471,081	0	42,471,081	42,471,081	0	0	0	0	0
1.3.1 5	Ngritja e strukturave/platformës së shpejtë të parimit të krimeve në fushën e ekonomisë të shpejtë të krimeve	91601AG	AAPSK	MD	2023	2025	960,000	0	960,000	960,000	0	960,000	960,000	0	960,000	2,880,000	0	2,880,000	2,880,000	0	2,880,000	0	0	0	0
1.3.1 6	Hartimi i procedurave standarde të përshkëlqimit vjetor për bashkëpunim ndërmjet AAPSK-së dhe Zërit të Rikuperimit të Aktive (ZRA)	91601AG	AAPSK	MB MD	2023	2025	170,400	0	170,400	0	0	0	0	0	170,400	170,400	0	170,400	170,400	0	170,400	0	0	0	0
1.3.1 7	Përmirësimi i elementeve funksionale të regjistrimit elektronik të parimit të ekonomisë/konfidencës	91601AH	AAPSK	AAPSK	2023	2025	480,000	0	480,000	480,000	0	480,000	480,000	0	480,000	1,440,000	0	1,440,000	1,440,000	0	1,440,000	0	0	0	0
1.3.1 8	Rejta e shprehimit të informacionit ndërmjetmjetor dhe ndërkombëtar në fushën e shtetit të ekonomisë dhe aksesit në detyrat përkatëse	91601AG	AAPSK	AAPSK	2023	2025	280,000	0	280,000	280,000	0	280,000	280,000	0	280,000	840,000	0	840,000	840,000	0	840,000	0	0	0	0
Kontingjencë Objektive specifike 1.3							308,767,992	42,471,081	351,239,073	132,808,494	0	132,808,494	132,808,494	0	132,808,494	574,384,983	42,471,081	616,856,064	574,384,983	42,471,081	616,856,064	0	0	0	0
1.4.	Objektivi specifik: Hetimi, ndjekja penale dhe dënimet i detyrësve dhe autoriteteve të autoriteteve kriminale																								0
1.4.1	Realizimi i vlerësimit të madhësive të detyrësve përfaqësues	91401AA	MD	BKSH Policia e Posaqme	2023	2025	1,505,000	0	1,505,000	1,505,000	0	1,505,000	1,505,000	0	1,505,000	4,515,000	0	4,515,000	4,515,000	0	4,515,000	0	0	0	0

25

26

Qëllimi i politikës I: ULJA E KERÇENIMIT DHE NDIKIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA															
Objektivat specifikë	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative totale			Burimi i mbulimit deri në 2025						Hendeku financiar 2023-2025 (në Lekë)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 123 ALL)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA 2023-2025 (në lek)			Financim i huaj (në lek)				
					Korrente	Kapitale	Totali, kosto	Korrente	Kapitale	Total BSH	Korrente	Kapitale	Total FH		
Goditja e veprimtarive kriminale në fushën e narkotikëve	Policia e Shtetit MSHMS	PP PU AISM SHISH Doganat AISM GdF/Projekti mbështetur nga BE	2023	2025	1,399,054,858	0	1,399,054,858	1,399,054,858	0	1,399,054,858	0	0	0	0	11,374,430
Goditja e trafikëve të paligjshme	MB Policia e Shtetit MK/IKRKT	MK/IKRKT AISM PU SHISH Doganat	2023	2025	3,927,231,000	230,956,560	4,158,187,560	3,927,231,000	230,956,560	4,158,187,560	0	0	0	0	33,806,403
Goditja e krimit ekonomik	Policia e SHISH	SHISH	2023	2025	574,384,983	42,471,081	616,856,064	574,384,983	42,471,081	616,856,064	0	0	0	0	5,015,090


dhe pastrimit të parave	Shtetit AAPSK	DPT DPD DPPPP AMF AISM BSH QKB DHKA PU PP													
Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i drejtuesve dhe anëtarëve të strukturave kriminale	Policia e Shtetit; Ministria e Brendshme; Drejtoria e Përgjithshme e Burjeve	IEVP PP SHISH	2023	2025	1,052,904,709	1,359,651,490	2,412,556,199	1,052,904,709	94,420,000	1,147,324,709	0	1,265,231,490	1,265,231,490	0	19,614,278
Forcimi i bashkëpunimit policor ndërkombëtar	Policia e Shtetit	SHISH	2023	2025	470,935,200	0	470,935,200	470,935,200	0	470,935,200	0	0	0	0	3,828,741
Kapja e personave në kërkim ndërkombëtar	Policia e Shtetit	SHISH	2023	2025	387,210,060	0	387,210,060	387,210,060	0	387,210,060	0	0	0	0	3,148,049
Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja	Ministria e Drejtësisë	MEPJ	2023	2025	118,266,000	0	118,266,000	118,266,000	0	118,266,000	0	0	0	0	961,512
Kostoja totale, Qëllimi i politikës I (objektiva specifike 1.1+1.2+1.3+1.4+1.5+1.6+1.7)					7,929,986,810	1,633,079,131	9,563,065,941	7,929,986,810	367,847,641	8,297,834,451	0	1,265,231,490	1,265,231,490	0	77,748,504
Qëllimi i politikës II: MBROJTJA E QYTETARËVE, INSTITUCIONEVE DHE EKONOMISË															
Objektivat specifikë	Institucionet përgjegjëse		Afati i zbatimit		Kostoja indikative totale			Burimi i mbulimit deri në 2023						Hendeku financiar 2023–2025 (në lek)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 123 ALL.)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA 2021–2023 (në lek)			Financim i huaj (në lek)				
								Korrente	Kapitale	Totali, kosto	Korrente	Kapitale	Total BSH		
Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar	PSH	KL.GJ PP	2021	2025	87,390,000	0	87,390,000	87,390,000	0	87,390,000	0	0	0	0	710,488
Nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare mbi programet e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë	PSH AS	PSH KL.GJ Shkolla e Magistraturës	2021	2025	149,753,007	0	149,753,007	149,753,007	0	149,753,007	0	0	0	0	1,217,504
Zbatimi i qasjes parandaluese me karakter pasuror dhe ekonomik ndaj subjekteve të lidhur me veprimtari të krimit të organizuar dhe krimit e rënda	MB	PSH MFE	2021	2025	1,458,290,344	0	1,458,290,344	1,458,290,344	0	1,458,290,344	0	0	0	0	11,856,019
Kostoja totale, Qëllimi i politikës II (objektiva specifike 2.1+2.2+2.3)					1,695,433,351	0	1,695,433,351	1,695,433,351	0	1,695,433,351	0	0	0	0	13,784,011
Qëllimi i politikës III: RRIJTJA E FORCËS PARANDALUESE NDAJ KËRCËNIMEVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA															
Objektivat specifikë	Institucionet përgjegjëse		Afati i Zbatimit		Kostoja indikative totale			Burimi i mbulimit deri në 2023						Hendeku financiar 2023–2025 (në lek)	Kostoja totale në EUR (kursi i këmbimit: 1 EUR = 123 ALL.)
	Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues	Afati i fillimit	Afati i mbarimit				PBA 2021–2023 (në lek)			Financim i huaj (në lek)				
								Korrente	Kapitale	Totali, kosto	Korrente	Kapitale	Total BSH		
Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar	Policia e Shtetit	MASR IAL Prefekti i Qarkut	2021	2025	200,155,500	0	200,155,500	200,155,500	0	200,155,500	0	0	0	0	1,627,280
Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/ huaj për zona dhe komunitete vulnerabël	Policia e Shtetit AAPSK MB	MBZ/HR Policia e Shtetit MT/MT Bashkitë	2021	2025	405,378,000	0	405,378,000	405,378,000	0	405,378,000	0	0	0	0	3,295,756

		Prefekti I Qarkut MSHMS													
Kosto totale, Qëllimi i Politikës III (objektiva specifike 3.1+3.2)					605,533,500	0	605,533,500	605,533,500	0	605,533,500	0	0	0	0	4,923,037
Kostoja totale e PV-s					10,230,953,661	1,633,079,131	11,864,032,792	10,230,953,661	367,847,641	10,598,801,302	0	1,265,231,490	1,265,231,490	0	96,455,551


				Kostoja korrente	Kosto kapitale	Totali	%	
Kostot totale të PV	11,864,032,792	%		Qëllimi i politikës I	7,929,986,810	1,633,079,131	9,563,065,941	81
PBA 2023–2025	10,598,801,302	89		Qëllimi i politikës II	1,695,433,351	0	1,695,433,351	14
Financimi i Huaj	1,265,231,490	11		Qëllimi i politikës III	605,533,500	0	605,533,500	5
Hendek financiar 2023–2025	0	0						
		%						
		86	Kostoja totale PV		Lek	Euro		
Kostoja korrente	10,230,953,661			11,864,032,792		96,455,551		
Kostoja kapitale	1,633,079,131	14	PBA	10,598,801,302		86,169,116		
Total kosto	11,864,032,792		Financim i huaj	1,265,231,490		10,286,435		
			korrente	10,230,953,661		83,178,485		
			Kapitale	1,633,079,131		13,277,066		

Nevojat kapitale (në lek)


Qëllimi i politikave	Natyra/ tipologjia e kostove	Kostoja totale 2023-2025	Kostot e planifikuara PBA 2023-2025 Buxheti dhe donatorët	Hendeku financiar 2023-2025
Qëllimi i politikës I	Korrente	7,929,986,810	7,929,986,810	0
	Kapitale	1,633,079,131	1,633,079,131	
Qëllimi i politikës II	Korrente	1,695,433,351	1,695,433,351	0
	Kapitale	0	0	
Qëllimi i politikës III	Korrente	605,533,500	605,533,500	0
	Kapitale	0	0	
TOTALI [lek]		11,864,032,792	11,864,032,792	0
TOTALI [Euro] <i>1 euro = 123 lekë</i>		96,455,551	96,455,551	0



Natyra Ekonomike e Kostove të Planit te Veprimit



Kosto të lidhura me qëllimet e politikave



PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT
PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE
2024–2025
(ndryshuar me vendimin nr.458, datë 10.7.2024)

TABELA E PËRMBAJTJES

Shkurtime

PJESA I. KONTEKSTI STRATEGJIK

Hyrja dhe qëllimi

Konteksti i reformës dhe kuadri ligjor dhe institucional

Konteksti i përgjithshëm

Kuadri ligjor

Kuadri institucional

Arritje dhe mësimet 2021–2023

Rekomandimet nga raportet ndërkombëtare

Vizioni, parimet e përgjithshme, qëllimet politike

Vizioni

Parimet

QËLLIMET POLITIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

PJESA V: MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Shkurtime

AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AKKSHI	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
AP	Autoriteti përgjegjës
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
AKAP	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DSHSB	Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki
DVKM	Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin
DRSHSSH	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnim në Hetimet Penale
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimit

KB/UN	Kombet e Bashkuara
KRAT	Komitetet rajonale antitrafikim
KSH	Komiteti Shtetëror
KKSAT	Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik
MB	Ministria e Brendshme
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MEKI	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MKR	Mekanizmi i referimit të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal
MMHF	Mekanizmi i Mbrojtjes ndaj Dhunës së Fëmijëve
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJL	Njësi lëvizëse
OJF	Organizata jofitimprurëse
ON	Organizata ndërkombëtare
PKK	Pika e Kalimit Kufitar
PMF	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësi
ISHPSHSH	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
SPZ	Specialisti i policisë së zonës

TQNJ	Trafikimi i qenieve njerëzore
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat
VT	Viktimë trafikimi
VMT	Viktimë e mundshme trafikimi

PJESA I. KONTEKSTI STRATEGJIK

1.1 Hyrja dhe qëllimi

Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024–2025 është dokumenti më i rëndësishëm politik kombëtar, i cili koordinon aktorët shtetërorë, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile në përpjekjet e përbashkëta për të luftuar trafikimin e personave. PKV është një shprehje e qartë e vullnetit të qeverisë shqiptare për të marrë të gjitha masat e nevojshme të karakterit institucional, ligjor dhe buxhetor për t’u përgjigjur në mënyrë të koordinuar trafikimit të personave. Bazat e ndërhyrjeve dhe veprimeve të përcaktuara në PKV-në mbeten parandalimi, hetimi dhe ndjekja, mbrojtja dhe riintegrimi social dhe ekonomik i viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit.

Trafikimi i personave vijon të mbetet një fenomen shqetësues jo vetëm për Shqipërinë por edhe për vendet e rajonit, si dhe vendet e BE-së, ndaj për luftimin dhe goditjen e tij është e domosdoshme që të ketë një përgjigje ndërsektoriale, të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse nga të gjithë aktorët, shtetërorë dhe joshetëror kombëtarë dhe rajonal, të cilët duhet të ndërveprojnë në mënyrë të koordinuar dhe efektive.

Ky dokument është vazhdim i përpjekjeve dhe objektivave antitrafikim të parashikuara në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023, por të përshtatura me ndryshimet dinamike të formave dhe tendencave të trafikimit, vizionit të qeverisë, reformave të ndërmarra në fushën e antitrafikut, si dhe detyrimeve në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, proceseve rajonale dhe ndërkombëtare.

Me qëllimin e hartimit të një plani gjithëpërfshirës, aktual, të realizueshëm dhe konform detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka edhe në planin ndërkombëtar, janë analizuar dhe marrë në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të organizatave ndërkombëtare për sa i përket situatës së trafikimit të personave në Shqipëri dhe, konkretisht: Progresraporti i BE-së, Këshilli i Evropës (GRETA), Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat dhe Raporti Global i Departamentit Amerikan të Shtetit, për Trafikimin e Personave.

Bazë e rëndësishme për hartimin e PKV-së mbetet analiza e raportit të monitorimit për zbatimin e PKV-së 2021–2023. Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023 ishte një plan gjithëpërfshirës me 55 masa konkrete në zbatim të 5 objektivave specifike, për realizimin e të cilave janë përfshirë 46 institucione dhe struktura për të punuar bashkërisht për më shumë transparencë, llogaridhënie, eficiencë dhe efektivitet në përpjekjet kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda në vend. Bazuar në raportin e monitorimit nivelin e përgjithshëm të realizimit të Planit 2021–2023, për periudhën 2021–2023 është në vlerën 89%, me 43 masa të realizuara plotësisht, 6 masa të realizuara pjesërisht, si dhe 6 masa të parealizuar.

Niveli i lartë i zbatimit të masave është rezultat i përpjekjeve të vazhdueshme në mirëkoordinimin e veprimeve të institucioneve shtetërore me organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile.

Në këta 3 vjet, me rendësi për t'u theksuar është rritja e numrit të identifikimeve të VT-ve dhe VMT-ve, kryesisht nga njësitë lëvizëse që menaxhohen nga strehëzat, si dhe fuqizimi i grupeve vulnerabël të shoqërisë, VT-ve dhe VMT-ve nëpërmjet programeve që nxisin aftësimin profesional, punësimin dhe vetëpunësimin duke synuar integrimin e qëndrueshëm të VT-ve dhe VMT-ve, si dhe parandalimin e trafikimit.

Rritja e profesionalizmit të strukturave shtetërore ka qenë po ashtu një veprimtari e cila gjatë zbatimit të planit ka qenë e shtrirë si në nivel lokal ashtu edhe qendror, duke targetuar kryesisht punonjësit e administratës që ofrojnë shërbime dhe kanë detyra funksionale zbatimin e PSV-ve.

Përparime të rëndësishme konstatohen në zhvillimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me rishikimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, si dhe miratimin e udhëzimit të përbashkët të ministrave për ngritjen dhe funksionimin e Autoritetit Përgjegjës.

Ky plan synon që të adresojë sa më qartë të gjithë aksionin e strukturave shtetërore dhe jo shtetërore në luftën kundër trafikimit të personave duke zhvilluar me tej praktikatat e mira të krijuara, intensifikimin e përpjekjeve për të realizuar ndërhyrjet që nuk kanë pasur sukses në zbatimin e PKV 2021–2023, si dhe t'u përgjigjet rekomandimeve të raporteve ndërkombëtare.

1.2 Konteksti i reformës dhe kuadri ligjor dhe institucional

1.2.1 Konteksti i përgjithshëm

Një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare dhe të Ministrisë së Brendshme është forcimi i rendit dhe sigurisë publike, duke parashikuar këtu luftën kundër krimit të organizuar e trafikeve të paligjshme. Shqipëria ka një kuadër të plotë ligjor dhe nënligjor, si dhe një bazë të konsiderueshme dokumentesh strategjike, që adresojnë çështjet e krimit të organizuar.

Synimi strategjik i këtij dokumenti është realizimi i një sistemi të integruar të adresimit të të gjitha hallkave dhe elementeve që lidhen me trafikimin e personave dhe pasojat e tij, i cili bazohet në ndërveprimin efektiv institucional, brenda e jashtë vendit dhe bashkërendimin e veprimtarive.

Sikurse parashikohet dhe në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 përpjekjet për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit duhet të vijojnë dhe intensifikohen nga të gjithë aktorët e përfshirë në luftën kundër trafikimit të personave, duke pasur në fokus fëmijët viktimat trafikimi. Vlerësohet i domosdoshëm miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2024–2025, duke qenë se trafikimi i personave:

është një fenomen kompleks, që shkon përtej luftës kundër krimit të organizuar dhe lidhet drejtpërdrejt me garantimin e të drejtave të njeriut;

- është një fenomen që kërkon një qasje të fokusuar, gjithëpërfshirëse, më të gjerë se forcimi i aspekteve të hetimit dhe ndjekjes penale;

- kërkon garanci parandaluese dhe partneritet, mbrojtje dhe asistencë për viktimat e trafikimit, garanci që i jep një përqasje specifike, të veçantë dhe multidimensionale;

Plani Kombëtar i Veprimit bazohet në një analizë të përgjithshme mbi situatën aktuale të trafikimit në Shqipëri që identifikon faktorët determinues që qëndrojnë në themel të trafikimit, si dhe grupet më të prekura të shoqërisë, si: gratë/vajzat, fëmijët dhe komunitetet etnike romë dhe egjiptiane. Krahas renditjes së disa prej arritjeve më të rëndësishme gjatë periudhës 2021–2023, në Planin e Veprimit identifikohen si fusha që synohet të përmirësohen gjatë zbatimit të këtij plani;

- garantimi i përputhjes së legjislacionit kombëtar penal dhe procedural penal mbi trafikimin e personave me standardet evropiane dhe ndërkombëtare;
- forcimi i mekanizmave për mbrojtjen e viktimave në të gjithë zinxhirin e drejtësisë penale (qasja, akses në drejtësi);
- përmirësimi i reagimit nga policia, prokuroria dhe sistemi gjyqësor në drejtim të zbatimit rigoroz të ligjeve në fuqi, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, zhvillimit të procesit gjyqësor dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit;
- sigurimi i identifikimit fillestar dhe referimeve për mbrojtje të fëmijëve dhe të rriturve si viktimat/viktima të mundshme trafikimi për qëllime shfrytëzimi dhe referimi i menjëhershëm i tyre pranë shërbimeve të duhura të asistencës, bazuar në nevojat individuale në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të);
- garantimi në vazhdimësi i funksionimit efikas të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe shtrirja e tij në nivel qarku, bashkie (nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për marrjen e masave parandaluese dhe identifikimin e personave të trafikuar) në përputhje me standardet dhe PSV-të;
- garantimi dhe qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për viktimat/viktima të mundshme të trafikimit (fëmijë dhe të rritur në qendra ose jashtë, përfshirë asistencën sociale, mjekësore, psikologjike dhe ligjore, si dhe garantimi i respektimit të standardeve kombëtare të përcaktuara dhe PSV-ve;
- nxitja e kthimit dhe riintegritimit, si dhe përfshirjes sociale të të miturve dhe të rriturve si persona të trafikuar (VMT dhe VT) dhe ulja e rrezikut për personat e trafikuar për t'u riviktimizuar, ritrafikuar ose që të kthehen në trafikues;
- përmirësimi i parandalimit të trafikimit nëpërmjet forcimit të sistemeve mbrojtëse, krijimit të mundësive social-ekonomike dhe mundësive të tjera të jetesës, si dhe rritjes së ndërgjegjësimit;
- rritja e ndërgjegjësimit publik mbi të gjitha format e trafikimit të personave (trafikimi i brendshëm, shfrytëzimi për punë të detyruar të fëmijëve dhe të rriturve, lypja nga fëmijët etj.), si dhe pasojat e tij;
- forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar;
- bashkërendimi i të gjitha masave antitrafik dhe bashkëpunimi i frytshëm mes të gjithë aktorëve të përfshirë në luftën kundër trafikimit në Shqipëri dhe, veçanërisht, me Mekanizmin e Dhunës në familje dhe Sistemit të Integruar të Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel qendror dhe lokal;
- përmirësimi i menaxhimit të të dhënave dhe informacionit mbi trafikimin e personave, si dhe krijimi i një mekanizmi për monitorimin, vlerësimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të përpjekjeve antitrafik;
- sigurimi i qëndrueshmërisë financiare dhe institucionale të veprimtarisë antitrafik.

1.2.2 Kuadri ligjor

Kuadri ligjor që rregullon, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, luftën kundër trafikimit të personave, përfshin:

Legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë:

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;

Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve për sa i përket Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale;

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe Protokollin shtesë i Konventës për të Drejtat e Fëmijës për Shitjen e Fëmijës, Prostitucionin e Fëmijës dhe Pornografinë e Fëmijës;

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;

Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional/ “Protokolli shtesë mbi parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, në mënyrë të veçantë të grave dhe fëmijëve”;

Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional/ “Protokolli kundër Kontrabandimit të Emigrantëve në Rrugë Tokësore, Ajrore dhe Detare”;

Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave CEDAW;

Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”;

Konventa evropiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”;

Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore;

Konventa e Konferencës së Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”;

Konventa e Konferencës së Hagës “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”;

Konventa e Konferencës së Hagës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”;

Konventa e Konferencës së Hagës “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore”;

Konventa e Konferencës së Hagës “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore”;

Konventa e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit dhe abuzimeve seksuale”;

Konventa e Këshillit të Evropës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës”;

Konventa e Këshillit të Evropës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”;

Konventa e Konferencës së Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes” (miratuar në parim, nga Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e datës 26.5.2011);

Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit të Organeve Njerëzore;

Konventat e ILO-s nr. 29 “Për punën e detyrueshme”, 138 “Mosha minimale për pranimin në punë” dhe 182 “Për ndalimin dhe veprimet e menjëhershme për eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve”.

Legjislacionin shqiptar:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 110/a “Trafikimi i të rriturve”, neni 128/b, “Trafikimi i të miturve”, neni 298 “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, neni 124/b, “Këqtrajtimi i të miturit”, neni 117 “Pornografia”;

Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar;

Ligji nr. 108/2014, “Për policinë e shtetit”, të ndryshuar;

Ligji nr. 79/2021, “Për të huajt”;

Ligji nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar;

Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar;

Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit përmes masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

Ligji nr. 98/2017, “Për tarifatat gjyqësore në RSH”;

Ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”;

Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;

Ligji nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor”, të ndryshuar;

Ligji nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar;

Vendimi nr. 1140, datë 24.12.2020, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin e Veprimit 2021–2022”;

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 29.8.2018, “Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”;

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 195, datë 11.4.2007, “Për miratimin e Standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”;

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 15.2.2017, “Për miratimin e rregullores ‘Për mbrojtjen e fëmijëve në punë’”, i ndryshuar;

Vendimi nr. 933, datë 2.7.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë dhe Europol”, i ndryshuar;

Udhëzimi i përbashkët nr. 132, datë 8.9.2023, “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”;

Urdhri nr. 805, datë 1.8.2017, i ministrit të Brendshëm, “Për forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror”;

Memorandumi i mirëkuptimit, i Ministrisë së Brendshme, i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe i Prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Evropë në Shqipëri (OSCE) “Për promovimin dhe zbatimin e Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm” (nënshkruar në vitin 2007);

Marrëveshja e bashkëpunimit për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave (MKR), datë 26 qershor, 2023.

Nëpërmjet Planit të Veprimit përcaktohen detyrime konkrete për institucionet dhe agjencitë shtetërore dhe joshtetërore, si dhe përgjegjësitë dhe kontributi i tyre në luftën kundër trafikimit të personave duke garantuar një mbrojtje gjithëpërfshirëse për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit. PKV-ja ruan frymën e një bashkëveprimi të ndërsjellë të krijuar tashmë ndërmjet të gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë dhe synon forcimin e këtij bashkëpunimi dhe institucionalizimin e tij nëpërmjet aplikimit të një politike të hapur, proaktive dhe gjithëpërfshirëse. Një pjesë e mirë e aktiviteteve të nisura gjatë zbatimit të PKV 2021–2023, parashikohen të konsolidohen dhe fuqizohen më tej në Planin e Veprimit 2024–2025. Shembujt dhe praktikat e mira janë shprehur në aktivitete konkrete dhe të matshme.

1.2.3 Kuadri institucional

Ministria e Brendshme, bazuar në VKM-së nr. 604, datë 20.10.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, të ndryshuar, është institucioni kryesor përgjegjës i cili bashkërendon punën për parandalimin e trafikimit, mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit dhe riintegrimin e tyre.

Zbatimi i këtij plani veprimi bazohet në bashkëpunimin e shumë aktorëve shtetërorë ku rol më të spikatur ka Ministria e Brendshme dhe institucionet e saj të varësisë dhe përfshin një listë të gjerë aktorësh të tjerë shtetërorë. Ky Plan Veprimi është planifikuar të realizohet në bashkëpunim dhe me aktorë joshtetërorë, që përfshin organizatat ndërkombëtare dhe organizata jofitimprurëse të cilat ushtrojnë veprimtarinë në fushën e antitrafikimit dhe adresimit të faktorëve nxitës të tij.

Institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, që janë përgjegjëse dhe/ose bashkëpunojnë me Ministrinë e Brendshme për zbatimin e planit dhe për të shkëmbyer informacion, janë:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
Ministria e Drejtësisë;
Ministria e Financave;
Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
Ministria e Arsimit dhe Sportit;
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve;
Shërbimi Social Shtetëror;
Byroja Kombëtare e Hetimit;
Prokuroria e Posaçme;
Prokuroria e Përgjithshme;
Shkolla e Magjistraturës;
Dhoma Kombëtare e Avokatisë;
Autoriteti i Mediave Audiovizive;

Komitetet Rajonale Antitrafikim;
Njësitë e vetëqeverisjes vendore;
Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;
Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;
Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar;
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

1.2.4 Koordinimi ndërinstitucional

Sektori i Antitrafikut në Drejtorinë e Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin në Ministrinë e Brendshme, është struktura kryesore për koordinimin e aktiviteteve antitrafik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Kjo zyrë ka si detyrë kryesore koordinimin e përpjekjeve antitrafik në shkallë vendi e më gjerë në drejtim të 4 shtyllave kryesore: parandalimit, mbrojtjes dhe asistencës ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, ndjekjes penale të trafikantëve dhe personave të përfshirë në të, si edhe partneritetit qoftë ndërmjet institucioneve shtetërore, po ashtu, atyre shtetërore të pavarura, si edhe organizatave vendase dhe organizmave ndërkombëtare, partnere aktive në përpjekjet antitrafik.

Marrëveshja për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit përbën marrëveshjen bazë ndërinstitucionale dhe instrumentin më të rëndësishëm të dakordësuar ndërmjet 15 institucioneve dhe organizatash për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. MKR është rivitalizuar nëpërmjet ngritjes së Task-Forcës së MKR-së, e cila vë në lëvizje të gjithë mekanizmin, duke garantuar monitorimin e zbatimit të saj dhe bashkërendimin e veprimit ndërinstitucional të anëtarëve në MKR. Ky dokument është rishikuar në muajin qershor 2023 duke reflektuar ndryshimet strukturore të institucioneve të përfshira, me struktura të reja me qëllim koordinimin e përpjekjeve, të të gjitha strukturave të angazhuara me mbrojtjen e viktimave të trafikimit, parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave, si dhe me qëllim rritjen e rolit të inspektorëve të punës në identifikimin fillestar të viktimave të mundshme të trafikimit dhe adresimin e qasjes me “në qendër” viktimën nëpërmjet arsimimit dhe formimit profesional, ka përfshirë si anëtarë në MKR, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, institucion në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Autoriteti përgjegjës⁶ për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e VT/VMT, ngritur me udhëzimin e përbashkët nr. 132, datë 8.9.2023. Në AP trajtohen raste konkrete të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe përpunohen të gjitha të dhënat mbi këto raste deri në zgjidhjen e tyre, ku viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, i është dhënë ndihma e menjëhershme dhe afatgjatë. Ky udhëzim ka përfshirë në autoritet struktura të rëndësishme, si: Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Sektorin kundër krimit Kibernetik në Policinë e Shtetit etj. Autoriteti ka hartuar dhe miratuar rregulloren e funksionimit të tij, sipas parashikimeve të udhëzimit nr. 132, datë 8.9.2023.

⁶ Udhëzimi nr. 132, datë 8.9.2023, “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”.

Komitetet rajonale antitrafik (KRAT)⁷ janë struktura kryesore qendrore në nivel qarku për identifikimin fillestar të viktimave të mundshme të trafikimit, evidentimin e problemeve parësore në nivel rajonal/lokal dhe vlerësimin e gjendjes dhe përcaktimin e nevojave specifike të qarkut, të cilat drejtohen nga Prefekti i secilit qark.

Bordi Këshillimor për Viktimat/Viktimat e Mundshme të Trafikimit me 3 anëtarë i ngritur në prill 2019 funksionon si një strukturë këshilluese nga viktimat për viktimat dhe merr pjesë në hartimin e politikave dhe programeve për viktimat e trafikimit. Ka rol këshillimor për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen të drejtave të viktimave, të cilat rrjedhin nga legjislacioni dhe konventat ndërkombëtare. Luan rol aktiv në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi shfrytëzimin e personave për qëllime seksuale, punë të detyruar, lypje apo forma të tjera të shfrytëzimit.

Mbrojtja dhe asistenca ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit (VT/VMT) ofrohet në strehëzat e ngritura për viktimat e trafikimit si dhe në komunitet. Funksionojnë katër qendra: Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit (shtetërore), organizata “Tjetër Vizion”, Qendra Psikosociale “Vatra”, dhe Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë” (joshtetërore) që ofrojnë shërbime direkte dhe riintegruese për VT/VMT, si: asistencë psikologjike, shëndetësore, ligjore, formim profesional, ndërmjetësim për bashkim me familjet, punësim dhe edukim, për viktimat e mundshme dhe viktimat e trafikimit, të huaja ose vendase, fëmijë ose të rritur, meshkuj ose femra. Prej disa vitesh, mundësohen nga buxheti i shtetit, konkretisht, Programi Buxhetor “Përkujdesi social”- MSHMS, pagesat e 29 punonjësve socialë që ofrojnë shërbime në qendra rezidenciale jopublike dhe fondi i ushqimit për viktimat e trafikimit.

Gjithashtu edhe kujdesi shëndetësor ofrohet nga shërbimet shëndetësore publike, ku viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit, përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, kontributet shëndetësore të të cilëve mbulohen nga buxheti i shtetit.

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar ka rëndësi të madhe strategjike dhe politike në luftën kundër trafikimit të personave pasi është fenomen global dhe kërkon goditje dhe masa të koordinuara mes shteteve për të intensifikuar përpjekjet në luftën kundër trafikimit të personave. Janë marrë një sërë masash për intensifikimin e mëtejshëm të këtyre bashkëpunimeve duke vazhduar zbatimin e Marrëveshjeve dhe Protokolleve me Kosovën Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Greqinë dhe Mbretërinë e Bashkuar për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.

1.2.5 Arritje dhe mësimet 2021–2023

Nëpërmjet **proceseve të ndryshme reformuese, zhvillimit të kuadrit legjislativ, investimit në rritjen e kapaciteteve të personelit** dhe masave të tjera të ndërmarra me qëllim realizimin e objektivave të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023, janë realizuar një sërë arritjesh si nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit, dhe miratimi i udhëzimit të përbashkët nr. 132, datë 8.9.2023, “Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe asistencën e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”. Miratimi i udhëzimit të përbashkët është pasuar nga rregullorja për funksionimin e AP dhe formatet e raportimit.

Gjithashtu, në proces është rishikimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes MB, ISHPSHSH dhe PSH, duke përfshirë në këtë marrëveshje edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Grupi i punës për rishikimin e këtij dokumenti është ngritur dhe janë zhvilluar takime me anëtarët e GP. Pritet dakordësia finale mbi draftin për të vijuar me nënshkrimin e tij.

⁷ Urdhri i Kryeministrit nr. 6, datë 26.1.2017, “Për ngritjen e Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave, në çdo qark”).

Ministria e Drejtësisë vijon procesin për hartimin e Kodit të ri Penal. Në janar të vitit 2023 është krijuar grupi i ri punës me qëllim garantimin e finalizimit të procesit brenda afateve të përcaktuara. Kodi Penal është një akt tepër kompleks, i cili kërkon bashkëpunimin dhe konsultimin me një sërë institucioneve, me qëllim trajtimin e të gjitha problematikave të evidentuara në analizën e kryer si dhe përafrimin me aktet dhe standardet ndërkombëtare. Miratimi i një ligji të veçantë kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen e VT/VMT dhe përafrimi për aq sa është e mundur me direktivën përkatëse⁸ mbetet ende një masë e pazbatuar. Në vlerësimin e institucioneve shtetërore dhe organizatave evidentohet nevoja që një sërë çështjesh specifike që lidhen më luftën kundër trafikimit të personave dhe trajtimin e VT/VMT mbetet relevante.

Identifikimi, referimi, asistenca dhe riintegrimi i viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit kanë pasur fokus të shtuar duke synuar partneritete të qëndrueshme për të arritur synimet dhe objektivat strategjike. Konkretisht, janë hartuar dhe shpërndarë 9000 broshura orientuese për stafin arsimor, shëndetësor, shërbimin social, konsullor, policinë e kufirit, trafikeve dhe strukturat e tjera të policisë, njësitë lëvizëse, strukturat jo anëtare të MKR-së, në lidhje me zbatimin e PSV-ve. Punonjës të strukturave ligjzbatuese, profesionistë të vijës së parë, janë trajnuar lidhur me identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit.

Të gjitha viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit janë informuar dhe këshilluar për të drejtat e tyre dhe iu është ofruar gjithë ndihma e nevojshme shëndetësore, psikosociale, ligjore, formimi profesional, regjistrimi në gjendjen civile, regjistrimi në shkollë, kthimi vullnetar i asistuar, këshillim dhe ndërmjetësimi për punësim. Iu është siguruar ndihmë juridike e specializuar dhe falas që në fazë të hershme të procesit duke garantuar lehtësimin i aksesit në drejtësi.

Ka vijuar financimi nga buxheti i shtetit, nga Programi Buxhetor “Përkujdesi social” – MSHMS, për qendrat pritëse dhe riintegruese joshetërore për 29 punonjës socialë dhe ushqimi për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit, të akomoduar në strehëza. Konkretisht, për vitin 2021, 2022 dhe 2023 nga buxheti i shtetit në total/çdo vit është financuar **Organizata “Të ndryshëm dhe të barabartë”**, me vlerën 6,920,400 lekë (fond ushqimesh) dhe 20,280,974 lekë (fond pagash për 9 punonjës); **Organizata “Tjetër vizion”**, me vlerën 7,449,000 lekë (fond ushqimesh) dhe 18,606,205 (fond pagash për 9 punonjës); **Qendra Psikosociale “Vatra”**, me vlerën 6,920,400 lekë (fond ushqimesh) dhe 28,445,274 lekë (fond pagash për 12 punonjës), si dhe **QKPVT**, në vlerë 17,118,014 lekë (fond ushqimesh) dhe 50,739,000 lekë (fond pagash për 17 punonjës).

Gjithashtu, ngritja e njësive të reja lëvizëse ka mundësuar rritjen e numrit të identifikimeve të rasteve të trafikimit, kryesisht me qëllim lypjen punën e detyruar, vepra të ulëta kriminale etj.

Forcimi i kapaciteteve të linjës kombëtare falas 116-006 dhe aplikacionit “Raporto dhe shpëto” për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore, ka mbetur e pazbatuar plotësisht. Në muajin dhjetor 2023, Ministria e Brendshme vuri në funksion linjën 116006, e cila funksionon pranë Sektorit Antitrafik. MB-ja në bashkëpunim me UNICEF-in ka filluar projektimin e aplikacionit, duke synuar që të sigurohet si shërbim dhe të prodhojë rezultate të synuar në PKV 2024–2025. Rivitalizmi i linjës do të pasohet dhe me një fushatë të dedikuar informimi dhe promovimi nëpërmjet prodhimit dhe shpërndarjes së posterave informues mbi linjën kombëtare dhe aplikacionin në 12 qarqe, përfshirë 61 bashki, pikat e kalimit kufitar dhe qendrat informuese. Po ashtu pjesë e këtij aksioni do të jetë dhe trajnimi i punonjësve të sallës operative mbi komunikimin etik, referimin e problematikave të adresuara dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi.

⁸ Direktiva 2011/36 “Mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre”.

Vëmendje të shtuar do të ketë po ashtu edhe organizmi i takimeve dhe trajnimeve me gazetarët, mbi rolin e medias në parandalimin e trafikimit të personave, rëndësinë e trafikimit si shkelje serioze e të drejtave të njeriut dhe të drejtave në punë (shfrytëzimi në punë, shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve, lypja, shfrytëzimi seksual, martesat nën moshë), si dhe respektimin e garantimit të drejtës së ruajtjes së jetës private të VT/VMT dhe veçanërisht të fëmijëve, si kategoria më vulnerabël.

Vlerësohet shumë e rëndësishme që të gjithë personat e angazhuar në luftën kundër trafikimit të personave të trajtojnë çdo rast në përputhje me parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale duke garantuar të drejtën e ruajtjes së jetës private

Në drejtim të parandalimit dhe ndërgjegjësimin të komunitetit lidhur me fenomenin e trafikimit, janë organizuar takime ndërgjegjëse në shkolla, me komunitetet vulnerabël, me partnerë lokale si administratorë shoqërorë, punonjës të mbrojtjes së fëmijës, punonjës të strukturave në bashki si dhe çdo vit janë zhvilluar aktivitete gjatë Muajit Antitrafik. Është financuar ngritja e *start-up*-eve për grupe vulnerabël, kryesisht gra kryefamiljare, familje me probleme të theksuara sociale dhe ekonomike, fëmijë jetimë etj., si dhe është ofruar këshillim, mentorim, aftësim profesional dhe ndërmjetësim për punësim.

Në drejtim të koordinimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional, rajonal dhe ndërkombëtar, janë organizuar takime me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si takimi me donatorët, janë zhvilluar takime bashkërenduese rajonale dhe ndërkombëtare, të tilla si takimi me ekspertë të GRETA-s, UN, MARRI, UNODC, ICMPD, OSBE, janë realizuar takime me partnerët lokalë për prezantimin e PKV si dhe janë mbajtur takime periodike të anëtarëve të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe të autoritetit përgjegjës.

1.2.6 Rekomandimet nga raportet ndërkombëtare

Komisioni Evropian në kuadër të procesit *screening* mbi kapitullin 24, vlerëson se Mekanizmi Kombëtar i Referimit për viktimat (e mundshme) të trafikimit është funksional dhe ofrohet asistencë, megjithatë, identifikimi i viktimave të mundshme mbetet i pamjaftueshëm brenda territorit shqiptar, edhe mes migrantëve vulnerabël që hyjnë në vend ndaj, ka rekomanduar përmirësimin e identifikimit të hershëm dhe mbrojtjen e viktimave. Referuar kuadrit ligjor vlerëson se është përmirësuar duke përfshirë ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale por që ende nuk është zbatuar. Rekomandon financimin e strehëzave të drejtuara nga organizatat jofitimprurëse, si dhe financimin e mjaftueshëm për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit kundër trafikimit të personave.

Gjithashtu, rekomandon rritjen e përpjekjeve kundër trafikimit, duke u fokusuar veçanërisht në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe krijimin e një *track-record* mbi numrin e dënimeve përfundimtare për trafikim të qenieve njerëzore. Qasja e përqendruar te viktima duhet të jetë më e mirë dhe më e integruar sa i përket hetimeve dhe ndjekjeve penale.

Komiteti i Palëve në Konventën e Këshillit të Evropës për Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, nëpërmjet raportit të tretë të vitit 2020 ka njohur progresin e arritur nga autoritetet shqiptare në zbatimin e Konventës, kryesisht, për: ndryshimet legislative që forcojnë të drejtat dhe pozitën e viktimave të veprave penale dhe parashikojnë të drejta të veçanta për fëmijët viktima, viktima të abuzimit seksual dhe viktima të trafikimit të qenieve njerëzore; miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2018–2020, zbatimi i të cilit mbështetet nga një buxhet i dedikuar; ekzistencën e një njësie të specializuar që merret me hetimin e veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore në kuadër të Departamentit të Policisë Kriminale, si dhe ngritjen e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; rishikimin e Procedurave Standarde të Veprimit lidhur me zbatimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR); përpjekjet për përmirësimin e qasjes proaktive për

identifikimin e viktimave nëpërmjet krijimit të njërive lëvizëse që vizitojnë vendet ku ka rreziqe trafikimi si dhe angazhimin aktiv në bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Përveç progresit në çështjet më sipër, është rekomanduar që të merren masa për të adresuar çështjet lidhur me lehtësimin dhe garantimin e aksesit në drejtësi për viktimat e trafikimit duke siguruar që të marrin asistencë juridike të specializuar dhe ndihmë juridike falas në të gjitha fazat nga avokatë të specializuar për të trajtuar çështjet e trafikimit; lehtësimin dhe garantimin e aksesit të viktimave në kompensimin si nga autorët e veprës penale por edhe nga shteti; sigurimin që çështjet e trafikimit të hetohen në mënyrë proaktive, të ndiqen penalisht në mënyrë efektive dhe të çojnë në sanksione efektive, proporcionale dhe bindëse; identifikimin në mënyrë proaktive të viktimave të trafikimit, në veçanti edhe viktimat e trafikimit me qëllim shfrytëzimin në punë; ndihmën e ofruar ndaj viktimave të trafikimit duke siguruar financimin e duhur ndaj strehëzave të drejtuara nga organizatat jofitimprurëse, strehimin dhe akses në shërbime edhe të viktimave të trafikimit meshkuj dhe lehtësimin e riintegrit nëpërmjet trajnimeve profesionale dhe aksesit në tregun e punës.

Departamenti Amerikan i Shtetit, në raportin e publikuar në Korrik 2023, vlerëson përpjekjet e qeverisë shqiptare për eliminimin e trafikimit, kryesisht në kuadër të identifikimit, mbrojtjes dhe riintegrit të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit. Megjithatë, kërkohet ndërmarrja e veprimeve konkrete me qëllim përmbushjen e standardeve minimale në disa fusha kyçe, të tilla si hetimi, ndjekja penale dhe dënimi adekuat i trafikantëve si dhe parandalimi i trafikimit të personave. Me prioritet rekomandohet që të merren masa lidhur me hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin e trafikantëve duke marrë parasysh ashpërsinë e dënimit ndaj tyre dhe mosaplikimin e veprave penale më të lehta kur është e mundur; institucionalizimin dhe ofrimin e trajnimeve për institucionet e zbatimit të ligjit, prokurorët dhe gjyqtarët për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të trafikimit, duke përfshirë udhëzime për çështjet e pëlqimit dhe detyrimit në kontekstin e trafikimit të punës dhe seksit; zbatimin e qasjeve të përqendruara te viktima dhe masave mbrojtëse të viktimave-dëshmitarëve gjatë hetimeve, ndjekjeve penale dhe procedurave gjyqësore; trajnimin e gjyqtarëve për kthimin në çështjet penale, vendosjen e procedurave për sekuestrimin e pasurive nga trafikantët dhe krijimin e metodave efektive për shpërndarjen në kohën e duhur; integrimin e grupeve rome në proceset vendimmarrëse në lidhje me mbrojtjen e viktimave; funksionimin e qëndrueshëm të njërive lëvizëse dhe pjesëmarrjen efektive të punonjësve të zbatimit të ligjit në to; përfshirjen e shërbimeve të shëndetit mendor për viktimat dhe edukimin për fëmijët viktima, në shërbimet riintegruese; rritjen e fondeve dhe krijimin e mekanizmave për shpërndarjen e burimeve të përshtatshme financiare për strehëzat për viktimat e trafikimit të drejtuara nga organizata jofitimprurëse; zgjerimin e juridiksionit të inspektorëve të punës për të inspektuar bizneset që nuk janë të regjistruara ligjërisht; funksionimin efektiv të linjës telefonike dhe përfshirjen e numrave në fushatat ndërgjegjësuere; rritjen e përpjekjeve për identifikimin e popullsisë vulnerabël dhe trajnimin e punonjësve të policisë dhe zyrtarëve të tjerë të vijës së parë për identifikimin proaktiv të viktimave

1.3 Vizioni, parimet e përgjithshme, qëllimet politike

1.3.1 Vizioni

PKV-ja bazohet në vizionin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe, në veçanti, synon të sigurojë që qeveria shqiptare dhe të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshetërorë janë të angazhuar dhe përkushtuar për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e personave dhe për të siguruar mbrojtjen e individëve dhe grupeve vulnerabël nga trafikimi, marrjen e masave efektive ligjore ndaj autorëve të krimit të trafikimit të personave, si dhe mbrojtjen e respektimit të të drejtave të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe, veçanërisht, fëmijëve e grave.

Përgjatë gjithë dokumentit strategjik përçohet vizioni, se trafikimi i personave mund të parandalohet me sukses vetëm nëpërmjet fuqizimit social dhe ekonomik të grupeve dhe personave në nevojë, zbatimit efikas të ligjit dhe ndëshkimit të shkelësve, si dhe fuqizimit të shërbimeve dhe kapaciteteve në ndihmë të personave të trafikuar, qofshin këta viktimë apo viktimë të mundshme të trafikimit.

Ky vizion është në përputhje dhe me vizionin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030 “Shqipëria me një shoqëri pa trafikim, krim të organizuar dhe kërcënime terrorizmi, dhe me imazh të një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë”, në lidhje me objektivat e parashikuara për krijimin e një mjedisi të sigurt për shoqërinë, uljes së trafikimit të paligjshëm dhe në veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmes Shqipërisë, si dhe krijimin e një shërbimi hetimor bashkëkohor dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal.

Misioni i PKV-së është promovimi i një reagimi efektiv, adekuat dhe të bashkërenduar për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave të bazuar në bashkëpunimin ndërkombëtar, bashkëpunimin efektiv ndërinstitucional brenda vendit, pjesëmarrjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe përfshirjen së shoqërisë civile dhe komunitetit

Gjithashtu, ngritja e mekanizmave bashkërendues, duke filluar nga niveli bazë do të mundësonte qëllimin përfundimtar të çdo nisme antitrafik, që është identifikimi i çdo viktime trafikimi për t'i dhënë ndihmën, mbrojtjen dhe mbështetjen e nevojshme për një riintegrim efektiv dhe të qëndrueshëm në shoqëri.

1.3.2 Parimet

Ky plan veprimi mbështetet në parimet e mëposhtme:

Përgjegjësia shtetërore: shteti ka përgjegjësi të marrë masa për të reaguar dhe përgjigjur ndaj situatës së trafikimit në kohë, me efektivitet, në mënyrë gjithëpërfshirëse, të koordinuar dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare.

Respektimi i të drejtave të njeriut është konsideratë parësore: të drejtat e personave të trafikuar duhet të jenë në qendër të të gjitha përpjekjeve për të parandaluar e luftuar trafikimin dhe për të mbrojtur viktimat. Masat antitrafik nuk duhet të ndikojnë negativisht te të drejtat e njeriut dhe dinjiteti i personave dhe veçanërisht te viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit.

Sigurimi i mbështetjes efektive të viktimave të trafikut/viktimave të mundshme të trafikut: mbështetja e viktimave dhe të mbijetuarve të trafikimit bazohet në një qasje holistike, të ndjeshme nga pikëpamja gjinore, të përshtatur nga pikëpamja kulturele, që ka në qendër viktimat dhe konsideron efektet e traumës.

Qasje ndërinstitucionale: të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshetërorë të përfshirë në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, bashkëpunojmë në mënyrë efektive për të përmbushur objektivat/detyrimet e këtij Plani Veprimi.

PJESA II. QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT E VEÇANTË TË KUADRIT STRATEGJIK

PKV-ja bazohet dhe del në zbatim të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025, për të adresuar këto qëllime të politikës:

1. Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, me objektiv specifik dhe masë prioritare:

1.1 Goditja e trafikeve të paligjshme;

1.1.1 Rishikimi i kuadrit ligjor kombëtar;

1.1.2 Forcimi i kapaciteteve të strukturave të drejtësisë dhe Policisë së Shtetit për hetimin proaktiv, ndjekjen penale, dënimin dhe sekuestrimin e pasurive të trafikantëve;

1.1.3 Shkëmbimi i informacionit dhe koordinimi ndërinstytucional i strukturave përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale.

2. Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë, me objektiva specifike:

1.1 Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar;

1.1.1 Rishikimi i VKM-së nr. 499 “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit”;

1.1.2 Identifikimi në kohë të viktimave të trafikimit dhe VMT dhe ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes gjithëpërfshirëse dhe përkatëse për nevojat e tyre.

1.2 Rritja e profesionalizmit:

1.2.1 Rritja e kapaciteteve profesionale dhe institucionale për identifikimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

3. Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, me objektivat specifike:

1.2 Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar;

1.2.1 Shpërndarja e informacionit mbi trafikimin e personave;

1.2.2 Forcimi i kapaciteteve të linjës kombëtare falas 116-006, dhe aplikacionit “Raporto dhe shpëto” për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të trafikimit të personave;

1.2.3 Gjithëpërfshirja e shoqërisë dhe institucioneve.

1.3 Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabel;

1.3.1 Hartëzimi i nevojave për mbështetje nga partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë;

3.2.2 Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe koordinimi me partnerët.

PJESA III: MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Planin e Veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të ngarkuara për zbatimin e tyre konsiderohet i nevojshëm për të analizuar situatën reale gjatë dhe për të mbikëqyrur ecurinë periodike, me qëllim përmbushjen e tyre në mënyrë sa më efektive, në kohë dhe sipas targeteve të përcaktuara.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të kalojë përmes disa fazave si: mbledhja e të dhënave; analizimi i të dhënave; hartimi i raporteve periodike në nivel institucioni. Të gjitha institucionet e ngarkuara me zbatimin e Planit të Veprimit do të hartojnë raporte të unifikuara 6-mujore në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit, si dhe do të hedhin të dhëna në sistemin IPSIS.

Drejtoria e Politikave për Antitrafikun dhe Migracionin në Ministrinë e Brendshme do të jetë struktura përgjegjëse, e cila do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij plani veprimi.

Raportet vjetore të monitorimit dhe vlerësimit do të paraqiten për rekomandime edhe pranë Mekanizmit Kombëtar të Referimit.

PJESA IV. ANALIZA BUXHETORE

BURIMET FINANCIARE

Në këtë kapitull paraqitet shpërndarja e kostove treguese dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve të Planit të veprimit “Për luftën kundër trafikimit të personave 2024–2025”. Kostimi i Planit të Veprimit u realizua mbështetur në metodologjinë dhe praktikën e planifikimit buxhetor dhe është përfshirë vetëm periudha (2024–2025). Vlerësimi i kostove indikative është mbështetur gjithashtu në objektivat specifike dhe treguesit e përcaktuar për arritjen e tyre, si dhe në masat, aktivitetet dhe produktet e identifikuara për secilin aktivitet. Përlllogaritjet buxhetore janë bërë

duke përdorur instrumentin e rekomanduar nga IPSIS-ja, të përshtatur sipas udhëzimeve përkatëse.

Procesi i kostimit u mbështet gjithashtu në konsultimin me Programin Buxhetor Afatmesëm 2024–2025 (faza I), në konsultimet me të gjitha institucionet përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit, si dhe në kostot historike nga zbatimi i planit të mëparshëm. Në disa raste janë marrë në konsideratë dhe kostot e produkteve të PBA-së ose projekte të ngjashme.

Plani i veprimit shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i mbështetur në një detajim të hollësishëm të shpenzimeve për çdo aktivitet.

Gjatë procesit të kostimit janë identifikuar shpenzimet për secilin aktivitet dhe ato janë klasifikuar në kategori shpenzuese të paracaktuara, sipas formatit IPSIS mbi metodologjinë e kostimit. Për kategori të caktuara shpenzimesh si pagat, shpenzimet e trajnimit, seminarët, shpenzimet e udhëtimeve, shpenzimet e ekspertëve dhe disa kategori pajisjesh janë përdorur kostot standarde të përcaktuara në metodologjinë e kostimit. Përlllogaritja e kostove është bërë sipas viteve financiare.

Kostoja e përgjithshme e përlllogaritur për zbatimin e planit të veprimit “Për luftën kundër trafikimit të personave 2024–2025”, është rreth 283.8 milionë lekë ose rreth 2.8 milionë euro. Kursi mesatar për referencë është përlllogaritur me 102 lekë për 1 euro.


Tabela e mëposhtme, pasqyron kostot indikative, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 2 viteve të zbatimit të Planit të Veprimit 2024–2025.

Qëllimi i Politikave	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale 2024-2025	Kostot e Planifikuara PBA 2024-2025 Buxheti & Donator	Hendeku Financiar 2024-2025
Qëllimi i Politikës 1: ULJA E KËRCËNIMIT DHE NDIKIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA	Korente	36,876,919	35,076,919	1,800,000
	Kapitale	0	0	
Qëllimi i Politikës 2: MBROJTJA E QYTETARËVE, INSTITUCIONEVE DHE EKONOMISË	Korente	67,197,459	58,839,459	8,358,000
	Kapitale	0	0	
Qëllimi i Politikës 3: RRITJA E FORCËS PARANDALUESË NDAJ KËRCËNIMEVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA	Korente	156,758,088	131,870,088	47,888,000
	Kapitale	23,000,000	0	
TOTALI [Leke]		283,832,466	225,786,466	58,046,000
TOTALI [Euro]		2,580,295	2,052,604	569,078
1 euro 102 Leke				

Tabela: Kostot indikative të planit të veprimit “Për luftën kundër trafikimit të personave 2024–2025”


Për periudhën 2024–2025, shpenzimet e planifikuara në buxhetet e institucioneve përgjegjëse janë rreth 177,1 milionë lekë, të cilat janë planifikuara në buxhetin vjetor dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026. Totali i financimit të huaj, i evidentuar është rreth 48.6 milionë lekë.

Hendeku financiar për këtë periudhën është rreth 58 milionë lekë ose 20.5% e kostove indikative. Për periudhën 2024–2025, buxheti i shtetit pritët të financojë 62.4% të kostove indikative totale të zbatimit të planit për periudhën 2024–2025, ndërsa financimi huaj është 17.1%.




Shpenzimet kapitale përbëjnë 8.0% të kostove indikative, ndërsa kostot korrente 92.0%.

NATYRA EKONOMIKE E KOSTOVE TË
Planit të Veprimit



Shpenzimet sipas natyrës ekonomike

Të ndara sipas qëllimeve të politikave, kostot pasqyrohen në grafikun më poshtë. Qëllimi i politikës III, pritet të ketë në terma financiarë peshën më të madhe në zbatimin e PV, përkatësisht 63.4%. Qëllimi i politikës II arrin në nivelin 23.6%, ndërsa qëllimi i politikës I 13% të kostos së përgjithshme të planit.



Plani i veprimit do të rishikohet pas 6 muajve (në fund të vitin 2024) për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë konform nevojave dhe shpenzimeve buxhetore afatmesme. Për masat e planit që janë të pambuluara financiarisht, MB-ja dhe institucionet e tjera përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor, si dhe do të negociojnë me donatorë të ndryshëm për t'i bashkëfinancuar disa aktivitete.

ANEKS 1

TABELA E PKV-së ANTITRAFIKIM

I. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TERRORIZMIT DHE TRAFIKIMIT									
QËLLIMI I POLITIKËS 1: ULJA E KËRCËNIMIT DHE NDIKIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA									
OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1. Goditja e trafikeve të paligjshme									
Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Baseline	Synimet/ targets	
		Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues				2023	Viti 2024	Viti 2025
1.1.1	Masa prioritare: Rishikimi i kuadrit ligjor kombëtar								
Aktivitetet	Studimi i kuadrit ligjor për luftën kundër trafikimit të personave, parandalimin, mbrojtjen, hetimin dhe riintegrimin e VT/ VMT	MB	MEKI MSHMS MAS Organizata	2024	2024	Rekomandimet e studimit janë adresuar për ndryshime ligjore	0	1	0
	Analizë e legjislacionit mbi konfiskimin e pasurisë së personave të dënuar për kryerjen e veprës penale të trafikimit të personave, me qëllim identifikimin e pengesave për shpërndarjen e tyre të viktimat e v.p.	MB	MD AAPSK Organizata	2024	2024	Rekomandimet e adresuara për ndryshime ligjore	0	1	0
	Vlerësimi i legjislacionit të inspektimit të punës me qëllim ngritjen dhe forcimin e mekanizmeve të bashkëpunimit dhe koordinimit të ISHPSHSH-së me institucionet e tjera, që mundëson veprimin në kohë reale të kompetencave të ISHPSHSH-së dhe në subjektet joformale.	MEKI	ISHPSHSH	2024	2025	Qëndrim i unifikuar për ndryshimet ligjore	0	0	1
	Ndryshimi i Kodit Penal në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të RSH-së dhe rekomandimet (finalizimi i miratimit të ndryshimeve ligjore për nenet 124 /b, 128/b për të parashikuar shfrytëzimin ekonomik dhe trafikimin e brendshëm të fëmijëve (edhe në kuadër të PKV për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge 2019-2021), 52/a, 110/a, 114 (2) të Kodit Penal), si edhe ndryshimi për trafikimin e organeve njerëzore (sipas Konventës së Këshillit të Evropës)	MD	MB MSHMS PP DPPSH	2024	2025	Kodi Penal i ndryshuar	0	0	1
	Rishikimi i marrëveshjes së bashkëpunimit antitrafikim mes Koordinatorit Kombëtar, DPPSH-së, ISHPSHSH-së dhe përfshirja në të edhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve	MB	ISHPSHSH DPPSH DPT ON OJF	2024	2024	Marrëveshja e rishikuar dhe aprovuar. Numri i rasteve të identifikuara në lidhje me shfrytëzimin për punë, si rrjedhojë e inspektimeve të bashkërenduara mes Koordinatorit Kombëtar, DPPSH, ISHPSHSH	0	1	0
	Krijimi i një mekanizmi koordinues dhe monitorues për luftën kundër trafikimit të personave. Ngritja e Grupit Drejtues për antitrafikim, të përbërë nga zëvendësministrat e ministrave të linjës.	MB	Kryeministria Të gjitha Ministrat e linjës	2024	2024	Urdhri i Kryeministrit i miratuar	0	1	0
1.1.2	Masa prioritare: Forcimi i kapaciteteve të strukturave të drejtësisë dhe Policisë së Shtetit për hetimin proaktiv, ndjekjen penale, dënimin dhe sekuestrimin e pasurive të trafikantëve								
Aktivitetet	Miratimi i kurrikulave të dedikuara për strukturat e drejtësisë (gyqtarë, prokurorë, oficerë të policë gjyqësore) dhe strukturave të policisë së shtetit për hetimin proaktiv, zbatimin e procedurave të ndjekjes penale në mënyrë efektive, përdorimin	Akademia e Sigurisë Shkolla e	MB DPPSH Organizata	2024	2024	Kurrikulat e miratuara	0	1	1

	e teknikave speciale të hetimit, hetimit financiar, zbatimin e sanksioneve proporcionale.	Magjistraturës							
	Trajnimi i strukturave gjyqësore për t'u specializuar për veprat penale të trafikimit me qëllim hetimin proaktiv.	SHM	MB DPPSH PP KKSAT ON OJF	2024	2025	Numri i strukturave gjyqësore të trajnuar për veprat penale të trafikimit, ndarë sipas çështjeve të trajnimeve	50	60	70
	Trajnimi i punonjësve të patrullës së përgjithshme të policisë, të repartit "Shqiponja" dhe strukturave të tjera përgjegjëse për hetimin dhe mbledhjen e informacionit për çështjet e trafikimit për të rritur dhe fëmijë si dhe bashkëpunimi ndërsektorial.	Akademia e Sigurisë	MKR KKSAT DPPSH AMP OJF ON	2024	2025	Numri i përfituesve të trajnimeve mbi hetimin, mbledhjen e informacionit për çështjet e trafikimit dhe bashkëpunimin ndërsektorial Ndarja sipas pozicioneve - punonjësve të patrullës së përgjithshme të policisë repartit "Shqiponja" - struktura të tjera përgjegjëse	1500	1700	2000
	Specializimi dhe trajnimi i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të ngarkuar me hetimin dhe ndjekjen penale të TQNJ, mbi teknikat speciale të hetimit, hetimit pasuror, por edhe lidhur me kuptimin e veprave penale të TQNJ në zbatim të vendimit njëses nr. 217/2022 përfshi çështjet që lidhen me pëlqimin dhe shtrëngimin në kuadër të trafikimit për qëllim shfrytëzimi seksual apo punë të detyruar.	SHM	PP Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit BKH	2024	2025	Numri i personave të trajnuar	45	65	75
	Zhvillimi i analizave të përbashkëta me qëllim rritjen e përpjekjeve për hetime penale proaktive	DPPSH	PP SPAK	2024	2025	Numri i hetimeve proaktive	-	Rritës	Rritës
	Monitorimi dhe identifikimi i zyrtarëve dhe punonjësve të institucioneve publike ligjzbatuese, të cilët janë përfshirë në trafikimin e personave dhe inkurajimi i publikut për raportimin e zyrtarëve të korruptuar	AMP	DPPSH OJF	2024	2025	Numri i zyrtarëve dhe punonjësve të institucioneve publike ligjzbatuese, të cilët janë përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore të proceduar	0	Rritës	Rritës
1.1.3	Masa prioritare: Shkëmbimi i informacionit dhe koordinimi ndërinstytucional i strukturave përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale								
Aktivitet	Krijimi i një praktike të re koordinimi për shkëmbim informacioni periodik lidhur me evidentimin dhe referimin e çështjeve penale të trafikimit të qenieve njerëzore	MB	PP KKSAT MKR DPPSH Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit BKH	2024	2024	Praktika e re e koordinimit funksionale	0	1	0
	Raportimi efektiv dhe periodik i rasteve kur ndaj personave ka filluar ndjekja penale dhe më pas ata identifikohen si VT/VMT, me qëllim përjashtimin e tyre nga përgjegjësia penale kur janë në kushtet e mbrojtjes nga ligji, analizimin e tyre dhe vlerësimin e nevojave për trajnim të punonjësve të drejtësisë	DPPSH	PP	2024	2025	Numri i rasteve kur ndaj personave ka filluar ndjekja penale dhe më pas identifikohen si VT/VMT	11	Rritës	Rritës

	Koordinimi dhe organizimi i hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta, në hetimet financiare me qëllim identifikimin e rasteve të mundshme të trafikimit të personave dhe rritjen e numrit të procedimeve penale të suksesshme.	DPPSH	MB PP Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit BKH	2024	2025	Numri i operacioneve identifikimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore dhe hetimeve financiare të përbashkëta të kryera	-	Rritës	Rritës
I. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TERRORIZMIT DHE TRAFIKIMIT									
QËLLIMI I POLITIKËS II. MBROJTJA E QYTETARËVE, INSTITUCIONEVE DHE EKONOMISË									
2.1	OBJEKTIVI SPECIFIK 2.1: Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar								
Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Baseline	Synimet/Targets	
		Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues				2023	Viti 2024	Viti 2025
2.1.1	Masë prioritare: Rishikimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 29.8.2018, "Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit"								
Aktivitetet	Realizimi i studimi mbi nivelin e zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit, miratuar me VKM-në nr. 499, datë 29.8.2018, nga strukturat përgjegjëse për identifikimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.	MB	MKR KRATOJF	2024	2024	Studimi i realizuar	0	1	0
	Organizimi i tryezave konsultuese të studimit me të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshetërorë që ushtrojnë veprimtari në fushën e antitrafikut	MB	MKR KRATOJF	2024	2024	Numri i institucioneve dhe organizatave të përfshira	0	1	0
	Identifikimi i problematikave dhe nevojave për ndryshimin/rishikimin e Procedurave Standarde të Veprimit	MB	MKR KRATOJF	2024	2024	Raport vlerësimi	0	1	0
	VKM nr. 499, të rishikohet bazuar në rezultatet e studimit, si dhe bazuar në praktikatat me të mira ndërkombëtare	MB	MKR KRATOJF	2024	2025	VKM e miratuar	0	0	1
2.1.2	Masë prioritare: Identifikimi në kohë i viktimave të trafikimit dhe VMT dhe ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes edhe nga shërbimet e punësimit, në përshatje me nevojat e tyre.								
Aktivitetet	Hartimi dhe botimi i broshurave informuese dhe manualeve të punës lidhur me punën e punonjësve të ISHPSHSH-së dhe AKPA-së ndaj VT-së dhe VMT-së.	MB	MEKIAKPA ISHPSHSH ON	2024	2025	Numri i broshurave të botuara; numri i manualeve; përfshirja e tyre në proceset e punës	-	2	2
	Trajnimi për çështje të mosdiskriminimit ndaj ofrimit të shërbimeve ndaj VT/VMT.	ASPA	KMDMEKIAKPA ISHPSHSH	2024	2025	Numri i punonjësve të AKPA-së dhe ISHPSHSH-së të trajnuar; vlerësime për rritjen e njohurive	120	130	150
	Trajnimi i profesionistëve që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me VT/VMT, për çështje të diskriminimit.	KMD	MB MKR	2024	2025	Numri i profesionistëve të trajnuar	0	50	50
	Punësimi dhe mbështetja me arsim e formim profesional i VT/VMT, nëpërmjet përfshirjes në programet e punësimit apo mundësive për bursat për fëmijët.	AKPA	MEKI	2024	2025	Përqindja e VT/VMT që kanë përfituar nga programet e punësimit; numri i bursave	50%	55%	60%
	Sigurimi i financimeve për njësitë lëvizëse për identifikimin e shpejtë dhe në kohë të VT dhe VMT.	MB	MSHMS ON	2024	2025	Rritja e fondeve për NJL	-	Rritës	Rritës
	Identifikimi i VT/VMT të mitur në kufi (përfshirë kalimin e paligjshëm të kufirit nga fëmijët), vetëm ose të shoqëruar me të rritur nëpërmjet kontrollit të detyrueshëm të dokumentacionit për fëmijët.	DKM	DPPSH PMF	2024	2025	Numri i të miturve VT/VMT të identifikuar gjatë kalimit të paligjshëm të kufirit në PKK	3	5	6

	Organizmi i vazhdueshëm i seancave të informimit për VT/VMT në lidhje me të drejtën për shërbime juridike dhe psikologjike dhe lehtësimi i aksesit në drejtësi, duke i siguruar ndihmë juridike të specializuar dhe falas që në fazë të hershme të procesit.	KKSAT	MB MD PP AP	2024	2025	Përqindja e VT/VMT të asistuar në lidhje me të drejtën për shërbime juridike dhe psikologjike dhe lehtësimi i aksesit në drejtësi për VT/VMT duke i siguruar ndihmë juridike të specializuar dhe falas që në fazë të hershme të procesit.	100%	100%	100%
	Ndërmarrja e hapave përkatës për garantimin e mbrojtjes së posaçme dhe efektive si dhe vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut për VT/VMT, dëshmitarët dhe anëtarët e familjes së tyre, brenda apo jashtë vendit, nga hakmarrja dhe kërcënimet e mundshme gjatë të gjitha fazave të procedimit penal, duke inkurajuar rritjen e bashkëpunimit të personave të trafikuar me institucionet e zbatimit të ligjit dhe duke aplikuar një qasje të orientuar te mbrojtja e VT/VMT.	DPPSH	PP KKSAT	2024	2025	Numri i rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore që kanë marrë mbrojtje të posaçme	-	Rritës	Rritës
	Informimi i përshtatshëm i VT/VMT veçanërisht për fëmijët duke përdorur një gjuhë miqësore, në lidhje me të drejtat që kanë, shërbimet në dispozicion dhe mënyrat e aksesimit të tyre, ndryshimet që ndodhin në rrethanat që prekin situatën e tyre përfshirë ndalimet, mbulimin nga media, ndryshimin e akuzave, ndërprerjen e procedurave etj.	MSHMS	NJMF SHSSH KKSAT OJF ON PP	2024	2025	Përqindja e VT/VMT të informuar dhe që kanë përfituar nga shërbimet ndihmëse	100%	100%	100%
	Sigurimi i ofrit të shërbimeve riintegruese për VT/VMT, nëpërmjet financimit të vazhdueshëm, në kuadër të Fondit Social të strehëzave dhe qendrave komunitare, si dhe nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të tyre mbi respektimin e standardeve të kërkuara.	MSHMS	MKR SHSSH KKSAT ON	2024	2025	Përqindja e VT/VMT që kanë marrë paketat e shërbimeve në qendra dhe në komunitet	-	Rritës	Rritës
	Zbatimi PSV-ve, i protokolleve shtesë dhe formateve të unifikuara për kthimin vullnetar të asistuar të VT/VMT, si dhe orientimi i NJMF-ve për plotësimin e saktë të formave dhe procedurave që përcaktojnë PSV-të.	MB	AP MEPJ NJMF SHSSH KKSAT OJF ON	2024	2025	Numri i kthimeve të asistuar VT/ VMT sipas procedurave të unifikuara	7	10	10
	Promovimi i ndërmarrjeve sociale në iniciativë që angazhojnë VT/VMT, personat me prejardhje të pafavorshme socio-ekonomike.	MSHMS	KKSAT OJF NJVQV Biznesi privat	2024	2025	Numri i ndërmarrjeve sociale dhe partneriteteve publik- privat, të cilat angazhojnë VT/VMT e personat me prejardhje të pafavorshme socio-ekonomike të promovuara	1	2	3
	Monitorimi i rasteve të fëmijëve VT/VMT të menaxhuara nga NJMF/PMF.	ASHMDF	SHSSH NJVQV OJF	2024	2025	Numri i monitorimeve të kryera për rastet e fëmijëve VT/VMT të menaxhuara nga NJMF/PMF	5	6	7

2.2	OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2: Rritja e profesionalizmit								
Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Baseline	Synimet/ Targets	
		Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues				2023	2024	2025
2.2.1	Masë prioritare: Rritja e kapaciteteve profesionale dhe institucionale për identifikimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit								
Aktivite	Rishikimi i strukturës së Avokatit të Popullit me qëllim përfshirjen e nënkomisionerit për trafikimit si raportues i pavarur	Avokati i Popullit	Parlamenti	2024	2025	Miratimi i strukturës së AP duke parashikuar edhe nënkomisionerin për trafikimin	0	0	1
	Trajnimi i punëdhënësve/bizneseve për identifikimin e hershëm dhe trajtimin e VT/VMT	MB	MKR Organizata	2024	2025	Numri i punëdhënësve të trajnuar	0	50	60
	Trajnimi i profesionistëve të ngarkuar për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit mbi procedurat standarde të veprimit të rishikuara	MB	AMP MKR, Organizata	2024	2025	Numri i profesionistëve të trajnuar	100	150	200
	Rritja e kapaciteteve të punonjësve të MEKI-së në nivel qendror për VT/VMT (punësim, e/imigrim dhe VET) për politikën në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore dhe pikëprejtes tyre me politikën e punësimit, VET, dhe e/imigrimin e punës – Trajtime periodike mbi politikën dhe legjislacionin e BE-së dhe vende me praktika të mira.	ASPA	MEKI ON	2025	2025	Numri i zyrtarëve të trajnuar; njohuritë e fituara; politika të përmirësuara	-	30	50
	Rritja e kapaciteteve të punonjësve të AKPA-së dhe ISHPSHSH-së për rritjen e njohurive për politikën në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore dhe politikën që këto struktura zbatojnë në fushën e punësimit, migrimit të punës dhe VET – trajtime periodike mbi zbatimin e legjislacioneve të ndryshme.	ASPA	MEKI AKPA ON	2025	2025	Numri i zyrtarëve të trajnuar; njohuritë e fituara; politika të përmirësuara dhe zbatuara me efikasitet	-	50	80
	Trajnimi i avokatëve për çështjet e trafikimit me qëllim mbrojtjen e VT/VMT dhe për të mbështetur VT/VMT në pretendimin e kompensimit.	DHKA	ON KKSAT OJF	2024	2025	Numri i avokatëve të trajnuar për çështjet e trafikimit me qëllim mbrojtjen e VT/VMT	-	30	50
	Trajnimi i vazhduar ndërdisiplinor i profesionistëve që punojnë me fëmijët/ të rinjtë për identifikimin e hershëm dhe trajtimin e VT/VMT	ASHMDF	MB Shërbimet sociale në NJVQV Nj L, GTN (Grupi Teknik Ndërsektorial në nivel Bashkie) ON OJF	2024	2025	Numri i profesionistëve që punojnë me fëmijët për identifikimin e hershëm dhe trajtimin e VT/VMT	-	40	60
	Trajnimi i punonjësve arsimorë në lidhje me identifikimin e VT/VMT, intervistimin e referimin dhe zbatimin e PSV-ve.	MB	MAS	2024	2025	Numri i punonjësve arsimorë të trajnuar	-	50	70
	Trajtime periodike të punonjësve shëndetësorë, përfshirë punonjësit e shëndetit mendor dhe punonjësit sociale në lidhje me identifikimin e VT/VMT, intervistimin e referimin dhe zbatimin e PSV-ve.	MSHMS	MB ON	2024	2025	Hartimi i moduleve të trajnimit; Numri i stafeve të kujdesit shëndetësor të trajnuar; Numri i stafeve të	-	40	50

						shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor të trajnuar; Numri i stafeve psikosociale në KSHP të trajnuara			
	Trajnimi i punonjësve konsullorë në lidhje me identifikimin e VT/VMT, intervistimin e referimin dhe zbatimin e PSV-ve.	MB	MB MKR AP KKSAT OJF ON Akademia Konsullore	2024	2025	Numri i personave nga grupet profesionale të trajnuar në lidhje me identifikimin e VT/VMT, intervistimin e referimin dhe zbatimin e PSV-ve konsullorë	-	50	60
	Trajnim i punonjësve të policisë, NJL dhe profesionistëve të tjerë mbi format e reja të trafikimit nëpërmjet mjeteve elektronike (online).	MB	DPPSH AMP ORGANIZATA	2024	2025	Numri i punonjësve të trajnuar		80	100
	Hartimi i broshurave orientuese për stafin konsullor, njësitë lëvizëse, strukturat joanëtare të MKR-së dhe punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, në lidhje me zbatimin e PSV-ve	MB	ASHMDF NJVQV MEPJ, OJF, ON Ekspertë të fushës	2024	2025	Numri i materialeve informuese të prodhuara për stafin konsullor, njësitë lëvizëse, strukturat e mbrojtjes në bashki, strukturat joanëtare të MKR, në lidhje me zbatimin e PSV-ve. Numri i personave të informuar në lidhje me zbatimin e PSV-ve	9000	9500	9800
I. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TERRORIZMIT DHE TRAFIKIMIT									
QËLLIMI I POLITIKËS III: RRIJTJA E FORCËS PARANDALUESE NDAJ KËRCËNIMEVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA									
3.1	OBJEKTIVI SPECIFIK 3.1: Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar								
Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Baseline	Synimet/ Targets	
		Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues				2023	Viti 2024	Viti 2025
3.1.1	Masë prioritare: Shpërndarja e informacionit mbi trafikimin e personave								

Aktivitetet	Organizimi dhe ndërmarrja e fushatës kombëtare ndërgjegjësuere në kuadër të muajit ANTITRAFIK - tetor	MB	MKR AP KRAT AMA OJF ON TV kombëtare dhe lokale Akademia	2024	2025	Numri i fushatave kombëtare dhe lokale të organizuara për informimin lidhur me format e trafikimit dhe efektin e tij në jetën e individit dhe shoqërisë (ndarja sipas fushatave të zhvilluara në televizion dhe medie sociale)	1	2	3
	Informimi mbi procedurat dhe adresa të strukturave që mbrojnë të drejtat e/e/imigrantëve. (E/Imigrim për motive punësimi i mirë-informuar nga dhe drejt Republikës së Shqipërisë, me qëllim shmangien e mundësive për abuzim.)	AKPA	MEKI DONATORE Akademia	2024	2025	Numri i VT/ VMT të informuar	-	Rritës	Rritës
	Informimi, i drejtpërdrejtë ose nëpërmjet medias/rreteve sociale apo broshurave informuese i VT/ VMT për shërbimet për të cilat kanë të drejtë në punësim dhe arsim dhe formim profesional.	AKPA	MEKI, DONATORE, Akademia	2024	2025	Numri i instrumenteve informuese të përdorur; numri i klikimeve në informacion; numri i broshurave dhe mundësive të informimit.	-	Rritës	Rritës
	Prioritizimi i tematikës së trafikimit në kuadër të thirrjes për propozime për projekte kombëtare të kërkim zhvillimit.	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	MAS, MB, Akademia	2024	2025	Projekte kombëtare të kërkimi zhvillimit me tematikë trafikimin	-	1	2
	Fuqizimi i kapaciteteve të universiteteve dhe institucioneve shtetërore për kërkime cilësore që zbatojnë parimet e etikës dhe integritetit në fushën e antitrafikimit	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit	MAS, Universiteti i Tiranës, Akademia	2024	2025	Numri i personave të trajnuar	-	50	100
	3.1.2 Mase prioritare: Forcimi i kapaciteteve të linjës kombëtare falas 116-006, dhe aplikacionit “Raporto dhe Shpëto” për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të trafikimit të personave								
	Vlerësimi i kapaciteteve dhe funksionalitetit të linjës kombëtare dhe aplikacionit raporto shpëto	MB	DPPSH	2024	2024	Studimi vlerësues i realizuar	0	1	0

Prodhimi dhe shpërndarja e posterave informues mbi linjën kombëtare dhe aplikacionin në 12 qarqe, përfshirë 61 bashki, pikat e kalimit kufitar, qendrat informuese etj.;	MB	KKSAT DPPSH OJF ON	2024	2025	Numri i rasteve të raportuara nga linja kombëtare falas 116-006, dhe aplikacionit “Raporto dhe Shpëto” për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore. (Ndarja: nr. i raportimeve në linjën kombëtare dhe atyre në aplikacion	-	Rritës	Rritës
Trajnimi i punonjësve mbi komunikimin etik, referimin e problematikave të adresuara dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi.			2024	2025	Numri i operatorëve të linjës kombëtare falas 116-006 për këshillimin dhe referimin e çështjeve të raportuara të trajnuar Numri i trajnimeve të zhvilluara Numri i fushatave të organizuara në mediet sociale për promovimin e linjës kombëtare dhe aplikacionit “Raporto dhe Shpëto!”	-	Rritës	Rritës
3.1.3 Gjithëpërfshirja e shoqërisë dhe institucioneve								
Informimi e ndërgjegjësimi i punonjësve të hotelarisë dhe turizmit për identifikimin dhe raportimin e VT/VMT, kryesisht gjatë sezonit veror	MTM	MB OJF OSBE Shoqata Shqiptare e Turizmit	2024	2025	Numri i punonjësve të hotelarisë dhe turizmit të informuar për identifikimin dhe raportimin e VT/VMT, kryesisht gjatë sezonit veror	-	Rritës	Rritës
Informimi dhe këshillimi i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit nga stafet konsullore në lidhje me format e shfaqjes së trafikimit me një fokus të veçantë të marrëdhëniet e rreme të punës edhe në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019–2023	MEPJ	MKR	2024	2025	Numri i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit të informuar dhe këshilluar nga stafet konsullore në lidhje me format e shfaqjes së	-	Rritës	Rritës

						trafikimit;			
	Informimi i vazhdueshëm i azilkërkuesve, migrantëve të parregullt, në gjuhë që e kuptojnë për të drejtat e tyre dhe mbrojtjen nga fenomeni i trafikimit	MB	Drejtoria e Azilit DKM QPA Karrec, Gërhot, Kapshtice MKR	2024	2025	Numri i azilkërkuesve të informuar në gjuhë që e kuptojnë për të drejtat e tyre dhe mbrojtjen nga fenomeni i trafikimit	-	Rritës	Rritës
	Ngritja e një qendre multifunkionale në veri të vendit në bashkëpunim me partnerë joshitetorë për riintegrimin dhe mbështetjen e grupeve vulnerabël të shoqërisë, të riskuar nga trafikimi, përfshirë VT/VMT. - Për të ofruar asistencë dhe shërbime shëndetësore, ekonomike, formim profesional dhe ngritje kapacitësh për këto grupe vulnerabël.	MB	NJVQV ON OJF	2024	2025	Qendra Multifunkionale e ngritur dhe funksionale në veri të vendit	-	0	1
